

KUVENDI I DËSHTIMEVE

Raport i monitorimit të punës së
Kuvendit të Kosovës për vitin 2023

ZDRAVO

Autor: Naim Jakaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport është realizuar me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund (RBF). Qëndrimet e shprehura në këtë raport jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e RBF.

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Prill, 2024
Prishtinë, Republika e Kosovës

LISTA E SHKURTESAVE

KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
POKP	Platforma Online e Konsultimeve Publike
RrPK	Rregullorja e Punës së Kuvendit
PL 2022	Programi Legjislativ për vitin 2022
GP LV	Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!
GP PDK	Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës
GP LDK	Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës
GP AAK	Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës
GP LS	Grupi Parlamentar i Listës Serbe
GP MULTI ETNIK	Grupi Parlamentar i deputetëve nga komunitetet jo shumicë
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
GjK	Gjykata Kushtetuese
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
KiE	Këshilli i Evropës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
ME	Ministria e Ekonomisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	07
2. Zhvillimi i punimeve pa Program të Punës të miratuar në seancë plenare.....	13
2.1 Mosefikasiteti që bartet.....	14
2.2 Mosefikasiteti që nuk mbaron.....	15
3. Seancat plenare.....	15
3.1 Seanca të jashtëzakonshme për miratimin e pikave të rregullta.....	16
4. Propozimi i kundërligjshëm për miratimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat emergjente me furnizimin e energjisë.....	17
5. Mosrespektimi i Rregullores së Kuvendit nga Kryetari i Kuvendit për thirrjen e seancave të rregullta.....	17
6. Shpërthimi i dhunës gjatë zhvillimit të seancës së rregullt plenare.....	17
6.1 Përdorimi i dhunës, sjellje e papërshtatshme për përfaqësuesit e qytetarëve.....	18
7. Mospërmbushja e rolit mbikëqyrës.....	19
7.1 Mbikëqyrja e dobët e deputetëve ndaj Qeverisë.....	19
8. Mungesa kronike e kuorumit në seancë plenare.....	20
9. Interpretimi i gabuar i Rregullores së Kuvendit për mosfillimin dhe mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme.....	21
10. Gjuha (jo)parlamentare.....	22
10.1 Mospërmbajtja e një pjese të deputetëve në diskutimin mbi Projektligjin për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar mjekësor.....	23
11. Dështimi i Kuvendit për miratimin e Kodit Etik.....	24
12. Përfaqësuesit e qytetarëve me aktakuza.....	24
12.1 Lirimi nga akuza për Kryetarin e Kuvendit.....	25
13. Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike në seancë plenare dhe në komisionet parlamentare.....	25
14. Vonesat në zgjedhjen e organeve kolegjiale dhe individuale.....	26
15. Dështimet e njëpasnjëshme për zgjedhjen e një anëtari në KGJK.....	27
16. Transparenca e Kuvendit.....	27
17. Dështimi i vazhdueshëm për të siguruar votimin elektronik të deputetëve.....	28
18. Dështimi i Kuvendit për t'i publikuar materialet e komisioneve hetimore parlamentare.....	29
19. Aktiviteti legjislativ.....	29
20. Mungesa e bashkëpunimit të shumicës parlamentare në adresimin e kërkesave buxhetore të deputetëve opozitarë në ndarjet buxhetore vjetore për vitin 2024.....	31
21. Kuvendi vazhdon të dështojë në shqyrtimin e iniciativave qytetare.....	32
22. Kushtëzimi jokushtetues dhe joligjor për votimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	33
23. Komisioni për Legjislacion nuk respektoi Rregulloren e Kuvendit.....	38
24. Kuvendi evitoi dëmtimin e mundshëm dhe të pariparueshëm të fondeve të kursimeve pensionale.....	34

25. Shkelja e standardeve minimale të konsultimit publik për koeficientin e pagave.....	35
26. Miratimi i ndryshimeve në Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në kundërshtim me Kushtetutën dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.....	35
27. Injorimi i komenteve të shoqërisë civile për Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.....	36
28. Abuzimi/keqpërdorimi i shmangieve nga afatet procedurale.....	37
29. Mungesa e konsensusit për marrëveshjet ndërkombëtare dëmtoi interesin e qytetarëve.....	38
30. Pasojat e mungesës së pjesëmarrjes në punimet e Kuvendit të deputetëve nga komuniteti joshumicë serb.....	39
31. Bojkoti i deputetëve të Listës Serbe pamundëson votimin e propozim amendamenteve kushtetuese.....	40
32. Deklaratat jashtë rendit të ditës.....	41
33. Heshtja e komuniteteve joshumicë.....	43
34. Llogaridhënia e Qeverisë përballë Kuvendit.....	43
34.1 Pyetjet parlamentare për përgjigje me gojë.....	44
34.2 Mosdisiplinimi i Qeverisë.....	46
34.3 Kushtëzimi jokushtetues për të dhënë llogari përballë përfaqësuesve të qytetarëve.....	48
34.4 Interpelancat.....	49
34.5 Debatet parlamentare.....	50
34.5.1 Kufizimi i paarsyeshëm i kohës nga Kryeministrit të Kosovës për të qëndruar në sallë për t'iu përgjigjur çështjeve dhe pyetjeve të ngritura nga ana e deputetëve të Kuvendit.....	50
34.5.2 Mosprania e Kryeministrit ose e Ministri të Punëve të Brendshme në seancën e jashtëzakonshme për mbështetjen urgjente financiare për Policinë e Republikës së Kosovës.....	51
34.5.3 Mungesa e qasjes proaktive të Kryeministrit për të raportuar mbi zhvillimet në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.....	52
34.5.4 Përfaqësuesit e qytetarëve nuk debatojnë për kërkesat e minatorëve të Trepçës dhe për paralajmërimet për grevë të Policisë.....	53
34.6 Komisionet Hetimore.....	54
34.6.1 Kundërkushtetutshmëria e Komisionit hetimor parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje.....	54
34.6.2 Procedimi i kundërligjshëm për miratim i Raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës.....	55
34.6.3 Shumica parlamentare pamundësoi kryerjen e mandatit të Komisionit Hetimor.....	55
Annex 1: Aktiviteti total i deputetëve.....	56
Annex 2: Kuvendi në numra.....	59
Publikimi i Doracakut për Nisma Legjislative.....	60

1. Përmbledhje ekzekutive

Në shoqëritë demokratike me sistem kushtetues parlamentar, është obligative që institucioni më i lartë siç është vendi i përfaqësuesve të qytetarëve, Kuvendi, të iu dal zot kompetencave dhe përgjegjësive që ia garanton Kushtetuta e vendit, një sërë funksionesh, të cilat janë esenciale për funksionimin e tij. Kuvendi është thelbësor për formimin e jetës publike, ai siguron që qëndrimet publike të dëgjohen, aktivitetet e qeverisë të shqyrtohen dhe të mbikëqyren nga afër dhe ligjet të miratohen duke pasur parasysh interesin më të mirë të shoqërisë, në pajtim me Kushtetutën dhe vlerat të cilat i përfaqëson Kushteta e vendit.

Kuvendi i Kosovës, gjatë vitit 2023 ka dështuar t'i zbatojë disa nga aspektet kyçe për funksionim të mirëfilltë, në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe në pajtim me kërkesat ligjore dhe të Rregullores së Kuvendit.

Puna e këtij institucioni është karakterizuar nga vendimarrja në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, në disa raste nga vendimmarrja e kundërligjshme, nga mungesa e transparencës së plotë në çështje kyçe të punës së kuvendit. Më tutje, puna e Kuvendit, është përcjellë edhe nga gjuha joparlamentare, gjuha seksiste, raciste, mizogjene dhe gjuha homofobe, në ndërkohë gjatë vitit 2023 përfaqësuesit e qytetarëve u përplasën fizikisht gjatë punimeve në seancë plenare.

Kuvendi ka zhvilluar punime pa planifikim adekuat, ku në krahasim me vitin paraprak, Kryesia e Kuvendit kishte autorizuar draftimin e planeve për sesione, këtë vit, një propozim i tillë nuk u diskutua fare. Kjo për pasojë pati edhe fenomenin e vazhdueshëm të mosefikasitetit në shqyrtimin dhe miratimin e pikave të rendit të ditës, mosefikasitet që u bartë nga një vit në tjetrin. Kuvendi e nisi vitin 2023 me tetë seanca plenare të papërfunduara nga vitit 2022, me gjithsej 54 pika të rendit të ditës, në ndërkohë viti 2023 u përmbyll me 30 pika të papërfunduara të cilat u bartën në vitin 2024. Në anën tjetër, ky mosefikasitet prodhoi 39 vazhdime të 23 seancave të rregullta të cilat nuk arrinin të përfundonin në kohë për arsye të mungesës kronike të kuorumit, fillimisht nga shumica parlamentare, e më pas edhe nga mungesa e deputetëve thirrës të këtyre seancave, kryesisht opozitës parlamentare. IKD gjen se gjatë vitit 2023, Kuvendi keqpërdori mekanizmin e seancës së jashtëzakonshme për miratimin e pikave të rregullta të rendit të ditës.

Në raport me kundër kushtetutshmërinë, Gjykata Kushtetuese rrëzoi pjesërisht Ligjin për Pagat në Sektorin Publik dhe atë për Zyrtarët Publik, rrëzoi në tërësi Ligjin për Këshillin Prokurorial, ligje për të cilat IKD kishte dhënë komente dhe kishte publikuar analiza se miratimi i tyre ashtu siç i kishte sjellë Qeveria ishin në kundërshtim me Kushtetutën. GjK, po ashtu rrëzoi Ligjin për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg dhe Vendimin për shkarkimin e tetë (8) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Në një rast, GjK vlerësoi se është në përputhje me kushtetutën, Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, thirrja e seancës së dt. 13 korrik 2023 nga Kryetari i Kuvendit dhe Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Kuvendi i Kosovës, injoroi vërejtjet dhe komentet e shoqërisë civile në lidhje me miratimin e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës. Kuvendi miratoi këtë ligj në kundërshtim me Kushtetutën dhe Aktgjykimin e GJK-së, i cili për dispozita të njejta në vitin 2019 e rrëzoi atë pjesërisht. Ligji përfundoi në gjykatë për t'u vlerësuar kushtetutshmëria e tij nga grupi parlamentar i PDK-së. Kuvendi, injoroi po ashtu edhe komentet e shoqërisë civile për Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku prej disa vërejtjeve siç është ajo për kuotën gjinore, ligji u dërgua në GJK nga Avokati i Popullit

Sa i përket kundërligjshmërisë, Kuvendi vendosi në rend të ditës miratimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat emergjente me furnizimin e energjisë. Edhe pse një vendim i tillë ishte proceduar brenda afateve të parapara me Ligjin për Energjinë, ky vendim tejkalonte periudhën maksimale prej 180 ditëve që Kuvendi mund t'i jepte autorizime Qeverisë. Rasti i dytë që lidhet me kundërligjshmërinë është ai me rastin e miratimit të Raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar për menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku Kryesia e Kuvendit procedoi kundërligjshëm miratimin e këtij raporti, në anën tjetër edhe Kuvendi miratoi këtë raport duke qenë në dijeni për kundërligjshmërinë e këtij raporti.

Sa i përket respektimit të procedurave në pajtim me rregulloren e Kuvendit, IKD gjen se në tre raste Kuvendi i Kosovës zhvilloi punime pa miratuar rendin e ditës në seancë plenare, për arsye se ky rend i ditës nuk u votua në Kryesinë e Kuvendit në mungesës të kuorumit.

Në një rast, IKD gjen se Kryetari i Kuvendit interpretoi gabimisht Rregulloren e Kuvendit për mosfillimin dhe mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme për arsye se në sallë nuk ishin të pranishëm 61 deputetë. IKD vlerëson se kuorumi në seancë plenare është i domosdoshëm dhe i patejkalueshëm për votimin e projektligjeve dhe akteve të tjera të Kuvendit, por kuorumi nuk duhet të jetë pengesë për zhvillimin e debatit parlamentar, veçanërisht kur ajo është e thirrur nga 1/3 e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, bashkësi deputetësh që me Kushtetutë kanë të drejtën e propozimit edhe të amendamenteve kushtetuese.

Kuvendi dështoi të kryejë rolin mbikëqyrës të tij në dy aspekte, duke mos arritur t'i diskutojë dhe t'i hedhë në votim disa raporte të rëndësishme të institucioneve të pavarura, për shkak të mungesës së kuorumit në seancë plenare dhe në anën tjetër, dështimin për ta përcjellë me mbikëqyrje parlamentare Raportin me rekomandime për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-003 për mbikëqyrjen elektronike të individëve të cilëve u është kufizuar lëvizja me urdhër të gjykatës. Që nga miratimi i raportit, i cili përmbante rekomandimet, veçanërisht për urgjencën në ndarjen e mjeteve të nevojshme, asnjë deputet i Kuvendit të Kosovës nuk ngriti çështjen e zbatimit të këtyre rekomandimeve përmes instrumenteve të kontrollit parlamentar, siç janë pyetjet parlamentare për përgjigje me gojë dhe me shkrim, përmes ngritjes së interpelancës për ministrat e caktuar, ose përmes ngritjes së kësaj çështjeje në pikën e deklarimit jashtë rendit të ditës.

IKD, gjen se Komisioni për Legjislacion, përkundër formimit të grupit punues për hartimin e Kodit Etik, ai ende nuk ka dorëzuar formalisht në komision këtë kod për ta shqyrtuar dhe proceduar në Kuvendin e Kosovës.

IKD, gjen se gjatë vitit 2023 Qeveria dhe deputetët, në disa raste ndërhyjnë në drejtësi duke bërë deklaratë publike dhe duke sulmuar drejtues të organeve të drejtësisë.

IKD gjen se Kuvendi në fusha të caktuara ka vazhduar të përballet me mungesë të thellë të transparencës. Që nga publikimi i gjetjeve në Raportin për punën e Kuvendit gjatë vitit 2022 nuk është bërë lëvizje e duhur dhe pozitive në drejtim të publikimit të të gjitha materialeve me rastin e mbajtjes së një seance parlamentare. IKD gjen se komisionet parlamentare i mbajnë mbledhjet e hapura, por të njëjtat vazhdojnë të mos transmetohen përmes faqes zyrtare të Kuvendit përmes Radio Televizionit të Kosovës ose edhe përmes ndonjë entiteti tjetër siç janë agjencitë e lajmeve. Përkundër premtimit që votimi elektronik do të zgjidhet shpejtë, Kuvendi ka dështuar që këtë çështje ta rregullojë. Për shkak të mungesës së votimit elektronik, shpesh herë ka ndodhë që numërimi i votave të mos jetë i saktë dhe të përsëritet në më shumë se dy herë dhe sërish të mos jetë i qartë në fund rezultati. Në anën tjetër, Kuvendi vazhdon të mos respektojë Rregulloren e Kuvendit me rastin e publikimit të votës së deputetëve ku kjo rregullore kërkon që votimi me dorë të bëhet publik menjëherë pas përfundimit të seancës plenare.

Në lidhje me aktivitetin legjislativ, ai u përshkrua nga mosefikasiteti i Kuvendit në miratimin projektligjeve dhe pikave të tjera të rendit të ditës, përgjithësisht, ndikim pati mungesa kronike e kuorumit që në shumicën e rasteve u shkaktua nga deputetët e shumicës parlamentare, veçanërisht te projektligjet ku kërkohet shumicë e thjeshtë e votës. Në anën tjetër, edhe këtë vit, përveç në masë më të madhe, u shfaq fenomeni i mosvotimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për të cilat në procesin e vendimmarrjes nuk merrnin pjesë deputetët e opozitës parlamentare.

Shumica parlamentare në vazhdimësi është treguar arrogante sa i përket bashkëpunimit me deputetët opozitarë për miratimin e Ligjit për Ndarjet Buxhetore Vjetore për vitin 2024. IKD gjen se me rastin e procedimit të këtij projektligji asnjë nga 54 amendamentet e propozuara në buxhetin vjetor të parashtruara nga deputetët e opozitës nuk janë votuar.

IKD, gjen Kuvendi vazhdon të dështojë në shqyrtimin e iniciativave qytetare. Që nga viti 2021, deputetëve të Kuvendit të Kosovës u është shpërndarë një nismë legjislative e mbi 10 mijë qytetarëve por ajo nuk është shqyrtuar në mungesë të caktimit të një deputeti nga përfaqësuesi i nismës legjislative. Ky i fundit, ka njoftuar Kryetarin e Kuvendit dhe Kryesinë për vullnetin e tij që ai vet ta shpalojë projektligjin para deputetëve, pasi që sipas tij, një mundësi e lë edhe Ligji për Nisma Legjislative.

Ndryshimet që u bënë me rastin e miratimit të Rregullores së re përfshinin që ndarjet buxhetore të shqyrtohen me procedurë të veçantë në raport me projektligjet e tjera, si dhe që në trajtimin e këtyre ndarjeve të përfshihen të gjitha komisionet parlamentare në raport me funksionet dhe përgjegjësitë mbikëqyrëse dhe me këtë rast të ftoheshin edhe krerët e këtyre institucioneve. Një gjë e tillë nuk u praktikua nga Komisioni për Legjislacionin i cili në mbledhje nuk i ftoi krerët e institucioneve të drejtësisë për të diskutuar në lidhje me kërkesat që nuk janë adresuar para miratimit të ndarjeve buxhetore me 31 tetor 2023.

IKD, gjen se Kuvendi evitoi dëmtimin e mundshëm dhe të pariparueshëm të fondeve të kursimeve pensionale kur në seancën e mbajtur me 19 maj 2023 nuk e votoi nismën legjislative të 21.398 qytetarëve të Kosovës, të cilët propozuan tërheqjen e një pjese të kursimeve pensionale.

IKD, gjen se Kuvendi shkeli standardet minimale të konsultimit publik për koeficientin e pagave, me ç'rast në njërin anë Qeveria nuk paraqiti projektligjin në konsultime publike kurse në anën tjetër edhe Kuvendi projektligjin përmes të cilit u caktua vlera e koeficientit të pagave u miratua me procedurë të përshpejtuar brenda një dite, duke mos marrë për bazë që me Rregulloren e Kuvendit parashihen edhe aktivitete që do t'i shërbenin në të mirë përmbajtjes së projektligjit, siç janë dëgjimet publike legjislative.

IKD, gjen se Kuvendi ka rritur përdorimin e miratimit të projektligjeve me shmangie nga afatet procedural të rregullta të disa projektligjeve të rëndësishme. Gjatë vitit 2023, Kuvendi përdori procedurat e shmangies në 22 raste, pesë raste më shumë se sa në vitin 2022. Të gjitha propozimet erdhën nga grupi parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! Propozimet për shmangie të procedurave përfshinin çështje që lidheshin me vendime të Qeverisë për masat emergjente në furnizimin e energjisë, çështje që lidheshin me ndarjet buxhetore për vitin 2023, më tutje ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personat e dhunuar gjatë luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre. Përmes shmangies është votuar reforma zgjedhore, ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për minierat dhe mineralet, ratifikimi i një anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Agjencinë Kosovare të Akreditimit, miratimi i Ligjit për çmimin e produkteve medicinale, ndryshimet në skemat pensionale si rezultat i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Nga monitorimi që IKD i bëri Kuvendit të Kosovës, ka gjetur se nëntë deputetët e Listës Serbe dhe një deputet i IQLDM-së marrin pjesë vetëm në seancat plenare kur është kusht i domosdoshëm që të mos ju humbet mandati sipas Kushtetutës dhe Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit. IKD, ka gjetur se mungesa e pjesëmarrjes në punimet e Kuvendit të deputetëve nga komuniteti joshumicë serb ka shkaktuar pasoja në pamundësinë e miratimit të ligjeve me interes vital dhe të amendamentit kushtetues nr. 27, i cili do të inkorporonte Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në nenin 22 të Kushtetutës dhe të amendamenteve kushtetuesë në lidhje me vetingun.

IKD, gjen po ashtu se Lista Serbe nuk është konstituar formalisht si grup parlamentar, ende nuk ka propozuar Nënkryetarin e Kuvendit, ende nuk ka propozuar kryetarin e Komisionit për të Drejtat e Komuniteteve dhe për Kthim si njëri ndër komisionet parlamentare kushtetuese dhe komision i përhershëm, e për më tepër nuk ka propozuar as anëtarët e këtij komisioni dhe anëtarët e tjerë për komisionet e tjera të përhershme dhe funksionale.

IKD gjen se nga të gjitha seancat e rregullta, Lista Serbe nuk është deklaruar as edhe njëherë te pika deklaratat jashtë rendit të ditës dhe në asnjë prej pikave të të tjera gjatë vitit 2023.

IKD gjen se Qeveria e Kosovës ka injoruar Kuvendin te pyetjet parlamentare për përgjigje me gojë, te komisionet hetimore dhe te debatet parlamentare për të dhënë përgjegjësi për punën e vet kushtetuese dhe për programin qeverisës të cilin e ka shpalosur para deputetëve në mars të vitit 2021. Në anën tjetër, IKD ka gjetur se edhe Kryetari ose ndonjëri nga nënkryetarët e Kuvendit nuk ka zbatuar në përpikëri Rregulloren e Kuvendit për t'i dhënë vërejtje publike kabinetit qeveritar kur shpërfill kërkesat e deputetëve.

Përgjithësisht, gjatë vitit 2023 IKD gjen se pyetjet parlamentare kanë qenë shpesh të paefektshme si një mjet për Kuvendin që ta mbajë qeverinë përgjegjëse. Shkaku kryesor i joefikasitetit në vitin 2023 ishte mospërfillja e Kuvendit nga ana e Qeverisë, veçanërisht tek kushtëzimi i Kryeministrit dhe ministrave në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Qeverinë, Kryeministri dhe ministrat mbajnë përgjegjësi para Kuvendit. Prej tyre pritet që t'u përgjigjen pyetjeve të deputetëve, të jenë proaktiv në dhënien e informacioneve dhe të japin përgjegjësi për politikën dhe veprimet e tyre gjatë qeverisjes së tyre.

Gjatë vitit 2023, Kuvendi është mbledhur vetëm në një interpelancë, e për numrin kaq të vogël të këtij instrumenti parlamentar, grupet parlamentare opozitare e kanë arsyetuar me faktin se një instrument i tillë grupeve të vogla parlamentare nuk u ofron kohë të duhur për t'i shprehur qëndrimet e tyre.

IKD, gjen se Kryeministri i Kosovës kufizoi në mënyrë të paarsyeshme qëndrimin e tij në sallë për t'u përgjigjur çështjeve dhe pyetjeve të ngritura nga ana e deputetëve të Kuvendit. Në një rast tjetër, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Brendshme nuk morën pjesë në seancën e jashtëzakonshme për të diskutuar mbi mbështetjen urgjente financiare për Policinë e Republikës së Kosovës.

Në raport me zhvillimet rreth dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, IKD gjen se ka munguar qasja proaktive të Kryeministrit për të raportuar mbi zhvillimet në të. IKD gjatë monitorimit të punës së Kuvendit ka gjetur se Kryeministri Kurti raportoi në Kuvend vetëm me kërkesë të grupeve parlamentare opozitare dhe asnjëherë me qasjen proaktive të tij për ta mbajtur të informuar Kuvendin për një temë me rëndësi siç është dialogu.

IKD, gjen se deputetët e shumicës parlamentare, nuk votuan për mocionin e deputetëve opozitarë që në rend të ditës të futej diskutimi mbi gjendjen e krijuar në Minierën e Trepçës. Në këtë minierë, minatorët u ngritën në grevë për për kushte më të mira, pagë më të mirë, për pagesa të rregullta mujore, për sigurime shëndetësore dhe jetësore. Përgjatë gjithë periudhës sa ata qëndruan në grevë, nuk u vizituan nga asnjë prej kërreëve institucionalë, siç është Kryeministri, Kryeparlamentari dhe Presidentja e vendit. Për më tepër, në dy javët e para ata nuk u vizituan as nga ministrja e Ekonomisë, si ministri e linjës në strukturën organizative të së cilës është edhe Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike.

Në raport me komisionet hetimore, Kuvendi themeloi komisionin hetimor në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje në Republikën e Kosovës si dhe komisionin tjetër lidhur me procedurat për furnizimin dhe menaxhimin me rezervat shtetërore, si dhe keqpërdorimet dhe abuzimet e mundshme me rezervat shtetërore, nëpërmjet kualifikimit të procedurës si sekret shtetëror për furnizime të tilla. Ndërsa, vazhduan punën dy komisionet e tjera të themeluara në vitin 2022.

IKD, gjen se kuvendi themeloi në kundërshtim me kushtetutën komisionin hetimor parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje ngase ai shkel parimet e ndarjes së pushteteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me standarde ndërkombëtare. Sistemi i drejtësisë nuk mund t'i raportojë në asnjë rrethanë pushtetit legjislativ, qoftë edhe përmes një komisioni hetimor.

IKD, gjen se shumica parlamentare pamundësoi kryerjen e mandatit të Komisionit Hetimor lidhur me procedurat për furnizimin dhe menaxhimin me rezervat shtetërore dhe hetim parlamentar lidhur me mundësitë e keqpërdorimeve dhe abuzimeve me rezervat shtetërore nëpërmjet kualifikimit të procedurës si sekret shtetëror për furnizime të tilla. Problemet që e përshkruan këtë komisionin ishin konstituimi i vonshëm i komisionit dhe mospjesëmarrja e vazhdueshme e anëtarëve të shumicës parlamentare.

Në anën tjetër, Kuvendi ka dështuar t'i publikojë materialet e komisioneve hetimore. Në faqen zyrtare nuk mund të gjindet asnjë procesverbal i mbledhjes publike i ndonjërit nga komisionet e themeluara.

Nga monitorimi i të gjitha fjalimeve të deputetëve të Kuvendit, rezulton se gjatë vitit 2023, deputetët e Kuvendit kanë mbajtur gjithsej 2114 fjalime. Me këtë rast, IKD gjen se 15 deputetë nuk kanë ngritur asnjë çështje nga totali ideklaratave gjatë vitit 2023, ku prej këtyre deputetëve 9 janë grupit parlamentar të Listës Serbe, një nga GP LV, një nga GP LDK, një nga GP MULTIETNIK, një deputet i subjektit politik GI za Slobodu, Pravdu i Opstanak (GI SPO), një deputet nga Partia Unike Gorane (JGP) dhe Një deputet nga subjekti politik Romani Iniciativa (RI).

2. Zhvillimi i punimeve pa Program të Punës të miratuar në seancë plenare

Kuvendi i Kosovës filloi sesionin pranveror dhe atë vjeshtor në vitin 2023 pa diskutuar në Kryesinë e Kuvendit[1] mbi Programin e Punës dhe pa e miratuar atë në seancë plenare.[2] Kryesia po ashtu në asnjë rast nuk miratoi kalendarin e punimeve njëmuje, ashtu siç kërkohet me Rregulloren e Kuvendit.[3]

Për herë të parë, Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2023 është mbledhur më 18 janar 2023,[4] me ç'rast njëjtë sikurse vitin e kaluar është filluar me vazhdim të seancës plenare për trajtimin e pikave të mbetura nga viti i kaluar. Po ashtu, sikurse në janar të vitit 2022, Kuvendi është mbledhur në seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar në lidhje me çmimin dhe faturimin aktual të energjisë elektrike për konsumatorët.[5] Në ndërkohë, puna e rregullt e Kuvendit ka filluar konform Rregullores së Kuvendit (Neni 37, par. 3 i Rregullores së Kuvendit).

Kuvendi u mblodh pa miratuar Programin e Punës për vitin 2023, edhe pse ishte parashikuar, si në Rregulloren e re, ashtu edhe në atë paraprake të Kuvendit. Programi i Punës së Kuvendit përmban agjendën legjislative të Qeverisë si dhe aktivitetet e përgjithshme të deputetëve dhe të Kuvendit.

Në krahasim me vitin paraprak, ku Kryesia e Kuvendit kishte autorizuar draftimin e këtij plani[6], të shqyrtuar më 4 prill 2022, këtë vit, një propozim i tillë nuk u diskutua fare, në mënyrë që të procedohet për miratim në seancë plenare e për më tepër as për të mbetur në nivel të diskutimeve në Kryesinë e Kuvendit.

Një propozim i nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevcit, në lidhje me organizimin e një takimi të përbashkët dhe punëtorive të rregullta për planifikim dhe caktim të prioriteteve u diskutua në mbledhjen e Kryesisë, të mbajtur më 13 shkurt 2023[7], por që në atë mbledhje si dhe në mbledhjet pasuese të Kryesisë nuk është diskutuar, nuk është planifikuar e as caktuar ndonjë datë e mundshme dhe nuk është ndarë buxhet për realizimin e këtij propozimi.

Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2023, Kuvendi funksionoi pa një plan të debatuar dhe miratuar në Kuvend. Përtej shkëljes së Rregullores së Kuvendit, mungesa e një programi të punës tregon edhe natyrën ad hoc të funksionimit të Kuvendit.

[1] "Procesverbal i Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 16 janar 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeDocumentFiles/Proc_nr_054_dt_16_01_2023_MK_znc6tUArmj.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[2] Neni 19, nënparagrafi 2.2.2, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2022. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/2022_08_09_RregulloreKuvenditteRepublikesseKosoves_LP5sAC4XSV.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[3] Neni 19, nënparagrafi 2.2.3, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2022. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/2022_08_09_RregulloreKuvenditteRepublikesseKosoves_LP5sAC4XSV.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[4] "Kalendari ditor i aktiviteve të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 18 Janar 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/shq/kalendari/?__RequestVerificationToken=SmoztOMvëOgëfZ4-kvpMCDsjQ5rVBUdREKirQPdbXfd6y1Y-ÈGRL0huHtkVMNptjIm6jule6ëazLIDY78FO6WFAKJgNÇzy2nca2GAXk_81&Date=01%2F18%2F2023). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[5] "Kalendari ditor i aktiviteve të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 18 Janar 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/shq/kalendari/?__RequestVerificationToken=jvzPRUje3HtFHmYPEBug5c5kN-f32x8haxFV3LSnT5Ugn70L9JbRUU_G7ahqY7Mob6PIhzkzQavuGijoA0OPORË74ybBnj76s-QVyOOJoLkI&Date=01%2F18%2F2024). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[6] "Procesverbal i Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 14 shkurt 2022. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeDocumentFiles/Proc_nr_027_dt_14_02_2022_MK_UxecqWj9Ny.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[7] "Procesverbal i Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 13 shkurt 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeDocumentFiles/Proc_nr_057_dt_13_02_2023_MK_n5fg3FERma.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

Kjo mënyrë e punës, duke vepruar sipas nevojës pa iu përmbajtur një plani të paracaktuar, veçanërisht për punën në seancat plenare, mund të jetë e dobishme për trajtimin e rrethanave që krijohen për shkak të ndonjë emergjence, por është joefektive dhe mungesë e konsistencës në proceset e punës si dhe pa rezultat pozitiv për punët që duhet trajtuar në plan afatgjatë - në mungesë të një programi të punës.

- **Fillimi I punës PA PROGRAM TË PUNËS**
- **Fillimi I punës së sesionit pranveror vjeshtor PA PROGRAM TË PUNËS**

2.1 Mosefikasiteti që bartet

Kuvendi e nisi vitin 2023 me tetë seanca plenare të papërfunduara nga vitit 2022, me gjithsej 54 pika të rendit të ditës të cilat nuk u përfunduan gjatë vitit 2022.[8] Në krahasim me vitin paraprak pati rritje të numrit të pikave të papërfunduara prej 16 pikave të rendit të ditës.

Numri i pikave të papërfunduara në vitin 2021	Numri i pikave të papërfunduara në vitin 2022
38	54

Tabela nr. 1 - Numri i pikave të papërfunduara në vitin 2021 dhe 2022

Nga 54 pikat e papërfunduara, 18 prej tyre janë projektligje e nga këto 12 projektligje për shqyrtim dhe votim në parim dhe dy projektligje për shqyrtim dhe votim në lexim të dytë, ndërsa 4 projektligje të tjera ishin projektligje për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Pikat e tjera kishin të bënin me zgjedhjen e organeve kolegjiale, mbajtjen e interpelancave (1), debateve parlamentare (1) dhe miratimin e propozim rezolutave (3). Më tutje, pikat e tjera kishin të bënin me bartjen e pikave që kanë të bëjnë me rekomandimet lidhur me auditimet financiare për pasqyrat financiare të ministrive të caktuara dhe agjencive e institucioneve të caktuara.

Kuvendit iu bartën edhe 15 raporte të agjencive dhe institucioneve që i raportojnë këtij institucioni, pastaj raporte mbi zbatimin e ligjeve të caktuara, votimi i strategjive të ndryshme,

[8] "Rendi i Ditës i Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, Kuvendi i Kosovës, Janar 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/shq/kalendari/?__RequestVerificationToken=RiULyI-6BGoFP6fEqHisxbruc3acTg-dL_Z13LJbJjIkbpzYBGwBkCvbi8cYdi0Z2jocDhIFiW3kF_AOA_wr2KkaLBHASU3rqFHqzNgcU1&Date=01%2F16%2F2023). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

votimi i kërkesave të institucioneve si dhe votimi i anëtarëve për disa organe kolegjiale dhe individuale. Në këtë mënyrë, pamundësia e përfundimit të pikave të rendit të ditës në vitin 2022 u reflektua si ngarkesë për Kuvendin në vitin 2023.

2.2 Mosefikasiteti që nuk mbaron

Fenomeni i mosefikasitetit në shqyrtimin dhe miratimin e pikave të rendit të ditës, të cilat, sipas afateve të parapara me Rregulloren e Kuvendit, i kanë plotësuar kushtet për t'u hedhur në votim, Kuvendin e Kosovës do ta përcjellë edhe në vitin 2024. Janë 27 pika të cilat barten nga viti 2023 dhe që presin të shqyrtohen dhe votohen nga ana e deputetëve të Kuvendit me të filluar puna në sesionin pranveror.

Nga 27 pikat e papërfunduara, gjashtë prej tyre janë projektligje në formatin e marrëveshjeve ndërkombëtare, pesë projektligje në shqyrtim të parë dhe pesë në shqyrtim të dytë, dy votime për anëtarë të institucioneve të pavarura. Pikat e tjera kanë të bëjnë me shqyrtimin e tri raporteve për zbatimin e ligjeve të caktuara, dy raporte vjetore të agjencive dhe institucioneve të pavarura, themelimi i një komisioni hetimor, votimi i një programi kombëtar, themelimi i një komisioni ad hoc dhe votimi i një projekt-deklarate.

3. Seancat plenare

Deri në fund të vitit 2023, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur gjithsejt 55 seanca:



Treguesi nr. 1 - Numri dhe lloji i seancave të mbajtura gjatë vitit 2023

Sa i përket seancave të rregullta, IKD gjen se fenomeni i caktimit të pikave të shumta të cilat nuk arrijnë të përfundojnë brenda një dite ka vazhduar edhe më tutje. IKD ka gjetur se nga 34 seancat e rregullta, 23 prej tyre janë mbajtur me vazhdime të seancave, që përbën 53% të seancave të rregullta.



Treguesi nr. 2 - Numri i seancave të rregullta, numri i vazhdimeve të atyre seancave dhe përqindja e vazhdimeve

Në këtë drejtim, IKD gjen se deri në fund të vitit 2023 janë mbajtur gjithsej 39 vazhdime të seancave:

Numri i seancave	Numri i vazhdimeve
4	3
8	2
11	2
Total	39

Tabela nr. 2 - Numri i seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme dhe numri i vazhdimeve

IKD gjen po ashtu se në vitin 2023 katër seancat e jashtëzakonshme janë përcjellë me fenomenin e vazhdimeve, seanca të cilat kryesisht nuk kanë marrë epilog në ditën kur janë thirrur, kjo për arsye të mungesës së kuorumit, fillimisht nga shumica parlamentare, e më pas edhe nga mungesa e deputetëve thirrës të këtyre seancave.

Në anën tjetër, IKD gjen se Kuvendi i Kosovës nuk i ka përfunduar 27 pika të rendit të ditës, ndër to edhe 16 projektligje për vitin 2023. Rrjedhimisht, ato do të trajtohen në seancat plenare për vitin 2024. Në raport me pikat e bartura për vitin 2024, vlen të theksohet se ka pika, trajtimi i të cilave ka tejkaluar çdo afat procedural, siç është rasti me mbi 60 pyetje parlamentare, e po ashtu edhe me pika ku trajtohen projektligjet dhe raportet e institucioneve dhe agjencive të pavarura.

3.1 Seanca të jashtëzakonshme për miratimin e pikave të rregullta

Për herë të parë në historinë parlamentare të Kosovës, Kuvendi mbajti seancë të jashtëzakonshme^[9] të thirrur nga grupi parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! për t'i miratuar gjashtë pika të rregullta të rendit të ditës, të cilat nuk kishin arritur të miratoheshin në mungesë të kuorumit në tre seanca të rregullta plenare. Në mesin e këtyre pikave ishin edhe raportet e institucioneve të pavarura për punën e tyre në vitin 2021 (Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë).

IKD gjen se, me rastin e thirrjes së kësaj seance u keqpërdor instrumenti i seancës së jashtëzakonshme. Seanca e jashtëzakonshme i referohet një mbledhjeje të Kuvendit, që mbledhet jashtë orarit të tij të rregullt për çështje ose rrethana specifike të cilat janë urgjente e që kërkojnë vëmendje të menjëhershme dhe nuk mund të presin deri në seancën e ardhshme të rregullt.

[9] "Transkript i Seancës Plenare, Kuvendi i Kosovës, 20 prill 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_04_20_ts_Seanca_ora13.30_dWxpqXn3fS.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

4. Propozimi i kundërligjshëm për miratimin e Vendimit të Qeverisë për masat emergjente me furnizimin e energjisë

Sipas Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, Qeveria e Kosovës ka të drejtë t'i propozojë Kuvendit të Kosovës vendim për vendosjen e masave emergjente në furnizim të energjisë. Këto masa përfshijnë kufizime në furnizimin me energji për konsumatorët ose edhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë. Një vendim i tillë do të jetë i vlefshëm në kohëzgjatje maksimale prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Kuvendi mund ta rrisë këtë periudhë deri në 180 ditë shtesë, por me kushtin që vendime të tilla merren për periudha të njëpasnjëshme prej tridhjetë (30) ditësh.

Në seancën plenare të mbajtur më 19 janar 2023, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! propozoi plotësimin e rendit të ditës për futjen e miratimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat emergjente me furnizimin e energjisë. Edhe pse një vendim i tillë ishte proceduar brenda afateve të parapara me Ligjin për Energjinë, ky vendim tejkalonte periudhën maksimale prej 180 ditëve që Kuvendi mund t'i jepte autorizime Qeverisë. Propozimi nuk mori votat e shumicës së deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, andaj për këtë arsye Qeveria u detyrua që të nxjerrë një vendim të ri më 25 janar 2023.

5. Mosrespektimi i Rregullores së Kuvendit nga Kryetari i Kuvendit për thirrjen e seancave të rregullta

Sa i përket zbatimit të Rregullores së Kuvendit të Kosovës gjatë seancave plenare, në tre raste Kuvendi i Kosovës zhvilloi punime pa miratuar rendin e ditës në seancë plenare, për arsye se ky rend i ditës nuk u votua në Kryesinë e Kuvendit në mungesës të kuorumit. Seanca ku u shpërfaq një praktikë e tillë e shkeljes së Rregullores së Kuvendit ishte seanca e datës 13 korrik 2023, ku fillimisht nuk është votuar rendi i ditës dhe më pas është futur në seancë të jashtëzakonshme pa marrë miratimin formal të seancës plenare, ashtu siç kërkohet sipas Rregullores së Kuvendit.

Formën e thirrjes dhe mbajtjes së kësaj seance, duke pretenduar në shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i PDK-së më 20 korrik 2023 e dërgoi për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese dhe me kërkesën për anulimin e kësaj seance. Gjykata Kushtetuese e shpalli të papranueshme këtë kërkesë.[10]

6. Shpërthimi i dhunës gjatë zhvillimit të seancës së rregullt plenare

Përveç gjuhës joparlamentare të përdorur nga kabineti qeveritar dhe nga deputetët, puna e Kuvendit u përcoll edhe me përplasje fizike mes kabinetit qeveritar dhe deputetëve opozitarë,

[10] "Aktvendim për papranueshmëri në rastin KO160/23, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 20 nëntor 2023. (Shih linkun https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/11/ko_160_23_av_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit më 10 janar 2024).

pastaj edhe ndërmjet deputetëve opozitarë me shumicën parlamentare. Një gjë e tillë u shpërfaq në seancën plenare të rregullt më 13 korrik 2023.[11]

Një praktikë e tillë e sjelljes së deputetëve konsiderohet se është në kundërshtim me standardet e larta profesionale dhe etike, të cilat janë parakusht për të ndërtuar besim të publikut në punën e përfaqësuesve dhe në integritetin e tyre.

Në këtë rast, IKD gjen se pas krijimit të rrëmujës dhe përplasjeve fizike ndërmjet disa anëtarëve të kabinetit qeveritar me disa deputetë të opozitës, Kryetari i Kuvendit ka thirrur brenda sallës Policinë dhe ka vazhduar të mbajë seancë plenare, përkundër se në këto situata, Rregullorja e Kuvendit kërkon pezullimin dhe vazhdimin e seancës në një ditë tjetër.[12] IKD po ashtu gjen se në sallën e Kuvendit të Kosovës, gjatë krijimit të rrëmujës ashtu siç ndodhi më 13 korrik, nuk mund të jenë të pranishëm policë civilë të cilët nuk janë të angazhuar drejtpërdrejt nga Policia e Kosovës për Kuvendin e Kosovës. Në këtë seancë, nga pamjet që transmetohen nga Kuvendi, shihet numër i madh i pjesëtarëve të mbrojtjes së afërt të Kryeministrit dhe policë të tjerë të cilët nuk kanë qenë të uniformuar si policët e tjerë që kujdesen për sigurinë në Kuvendin e Kosovës.

Në lidhje me rastin, Prokuroria Themelore në Prishtinë ftoi për intervistim zëvendëskryeministrin Besnik Bislimin, ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Muratin, si dhe deputetët e PDK-së: Mërgim Lushtakun, Bekim Haxhiun e Hajdar Beqën.

Më 30 tetor 2023, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë kundër zëvendëskryeministrit Besnik Bislimit dhe deputetëve: Hajdar Beqës, Bekim Haxhiut e Mërgim Lushtakut. Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi dhe deputetët Mërgim Lushtaku e Hajdar Beqa akuzohen për veprën penale “Sulmi”, kurse deputeti Beqa akuzohet edhe për veprën penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”, përderisa Bekim Haxhiu akuzohet për veprën “Lëndim i lehtë trupor”. [13]

6.1 Përdorimi i dhunës, sjellje e papërshtatshme për përfaqësuesit e qytetarëve

Në shtetet me demokraci të konsoliduar, përdorimi i dhunës në vendin ku mbliidhen dhe marrin vendime përfaqësuesit e qytetarëve nuk pranohet dhe shihet si i papërshtatshëm. Parlamentet janë forume ku deputetët e zgjedhur përdorin mënyra kushtetuese, ligjore dhe paqësore për të diskutuar çështjet dhe për të marrë vendime në emër të qytetarëve të tyre - të cilat në një fazë të hershme ose të vonshme kthehen në drejtësi, zhvillim ekonomik, social dhe politik

[11] "Transkript i Seancës Plenare, Kuvendi i Kosovës, 13 korrik 2023. (Shih linkun [10] "Aktvendim për papranueshmëri në rastin KO160/23, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 20 nëntor 2023. (Shih linkun https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/11/ko_160_23_av_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[12] Neni 67, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2022. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/2022_08_09_RregulloreeKuvenditteRepublikeKosoves_LP5sAC4XSV.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[13] Përleshja në Kuvend, aktakuzë ndaj Besnik Bislimit, Hajdar Beqës, Mërgim Lushtakut dhe Bekim Haxhiut. *Betimi për Drejtësi*, Tetor 2023 2023. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perleshja-ne-kuvend-aktakuze-ndaj-besnik-bislimit-hajdar-beqes-mergim-lushtakut-dhe-bekim-haxhiut/>). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

Përfaqësuesit e zgjedhur, konfliktet dhe mosmarrëveshjet e mundshme duhet t'i zgjidhin me mjete institucionale dhe ligjore dhe pa përdorur forcën. Ata duhet të udhëhiqen nga mbajtja e vlerave të mirësjelljes, respektit dhe jodhunës për ndërveprimet e tyre me njëri-tjetrin. Në të kundërtën, vetë deputetit/es, por edhe institucionit ku ai/ajo bën pjesë, i komprometohet besueshmëria dhe integriteti, paçka këta janë indikatorë të fuqishëm të procesit demokratik.

7. Mospërmbushja e rolit mbikëqyrës

Kuvendi “mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit”, kështu thuhet në Kushtetutë [neni 65.9]. IKD ka gjetur se Kuvendi nuk e ka përmbushur këtë detyrë themelore në vitin 2023.

Kuvendi dështoi të diskutojë dhe t'i hedhë në votim disa raporte të rëndësishme të institucioneve të pavarura, për shkak të mungesës së kuorumit në seancë plenare. Në mesin e tyre hyn Raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2022, Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2022. Më tutje, Kuvendi dështoi të diskutojë dhe të votojë Raportin me rekomandime nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-65 Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Rekomandimet nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 2003/5 për farërat, Rekomandimet nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.04/L-114 për pasurimin e miellit.

Në anën tjetër, Kuvendi dështoi që të përzgjedhë edhe një gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

7.1 Mbikëqyrja e dobët e deputetëve ndaj Qeverisë

Për shkak të mungesës së vazhdueshme të kuorumit, Kuvendi nuk arriti për një periudhë të gjatë që të shqyrtojë dhe votojë me kohë Raportin me rekomandime për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-003 për mbikëqyrjen elektronike të individëve të cilëve u është kufizuar lëvizja me urdhër të gjykatës. Raporti ishte radhitur për shqyrtim dhe miratim më 15 shtator 2022, por i njëjti u shqyrtua dhe votua më 3 maj 2023, pra me vonesë më shumë se gjashtë muaj.

Komisioni për Legjislacion kishte konstatuar se ligji është i pazbatueshëm në praktikë dhe se arsyeja pse ai nuk po zbatohet, nuk është se duhet të ndryshohet apo plotësohet, por sepse institucionet përkatëse – në këtë rast, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme - nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim.

Mjetet financiare nuk ishin ndarë asnjëherë, prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët nuk ishin në dijeni të këtij ligji, nuk ishin zhvilluar trajnime për këtë çështje e për më tepër nuk është bërë asnjë studim i fizibilitetit për të parë mundësinë e zbatimit të kësaj mase nga ana e këtij institucioni.

Në Raportin për monitorimin e punës së Kuvendit për vitin 2022[14], IKD ka gjetur se Kuvendi

[14] Jakaj N. “DOBËT-Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2022.” Prishtinë, Prill 2023. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/DOBET-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2022.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

IKD gjen se që nga miratimi i raportit, i cili përmbante rekomandimet, veçanërisht për urgjencën në ndarjen e mjeteve të nevojshme, asnjë deputet i Kuvendit të Kosovës nuk e ngriti çështjen e zbatimit të këtyre rekomandimeve përmes instrumenteve të kontrollit parlamentar, siç janë pyetjet parlamentare për përgjigje me gojë dhe me shkrim, përmes ngritjes së interpelancës për ministrat e caktuar, ose përmes ngritjes së kësaj çështjeje në pikën e deklarimit jashtë rendit të ditës.

Më 26 prill 2023, Qeveria e Kosovës me Vendimin nr. 12/140 ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për ndarjen e 600,000.00 (gjashtëqind mijë) euro për financimin e Projektit “Sistemi i monitorimit elektronik” për vitin 2023. Në një përgjigje për IKD-në, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjigjur se Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Policia e Kosovës, ka planifikuar buxhet për zbatimin e Ligjit për Mbikëqyrje Elektronike në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2024 – 2026). Sipas përgjigjes, vlera e saktë që është planifikuar është: 2,200,000 € për tri vite (2024 = 1,200,000€; 2025 = 500,000 € dhe 2026 = 500,000€).

IKD gjen se vendimi i Qeverisë së Kosovës dhe buxheti i ndarë për këtë dedikim ka filluar së ekzekutuari, pra procedurat e prokurimit për një çështje të tillë kanë nisur. IKD i është drejtuar me kërkesë për qasje në informata dhe qasje në dokumente publike Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës. Kjo e fundit ka kthyer përgjigje se projekti është iniciuar dhe është në procedurë dhe i njëjti është i klasifikuar.

8. Mungesa kronike e kuorumit në seancë plenare

Në vitin 2022, Kuvendi arriti të organizojë punën sipas praktikës së mëhershme, duke mbajtur seancë plenare të rregullt, të paktën, çdo të enjte. Në vitin 2023, për shkak të bartjes së pikave nga viti 2022 dhe për shkak të mungesës së kuorumit që me dhjetëra pika u mblodhën, Kuvendi dështoi të mblidhet çdo të enjte. Puna u organizua duke caktuar vazhdime të seancave të njëpasnjëshme e të cilat prodhuan pika të shumta të grumbulluara që nuk hidheshin në votim ose nuk merrnin epilog për shkak të mungesës së kuorumit.

Ushtrimi i detyrës së deputetit duhet të bëhet në mënyrën më të mirë dhe në interes të qytetarit. Ky aspekt nuk e përjashton atë nga pjesëmarrja fizike dhe aktive në trupat e Kuvendit, në komisione dhe në seancë plenare, veçanërisht te pjesëmarrja aktive përmes deklaratave dhe votimit për pikat e rendit të ditës. Mospjesëmarrja në punimet e seancës, duke mos u deklaruar për çështje ku ai është në komision dhe mos pjesëmarrja në votim, përbën shkelje të rolit kushtetues që ka deputeti.

Puna e Kuvendit gjatë vitit 2023 është karakterizuar fillimisht dhe në mënyrë sistematike nga mungesa e deputetëve të shumicës parlamentare në procesin e vendimmarrjes. Së dyti, mungesat janë shfaqur në një fazë tjetër nga radhët e deputetëve të opozitës.

Tabela nr. 1 tregon se në më shumë se gjysmën e seancave të rregullta ka pasur vazhdime, në disa seanca me pesë vazhdime e në disa me katër vazhdime.

9. Interpretimi i gabuar i Rregullores së Kuvendit për mosfillimin dhe mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme

Më 4 shtator 2023, grupet parlamentare opozitare kërkuan mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme, siç e quajtën ata 'Seancë në lidhje me dështimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për sigurimin e teksteve shkollore për nxënësit e nivelit të arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët për vitin shkollor 2023/2024'.

Deputetët u ftuan me ftesë nga Kryetari i Kuvendit për mbajtjen e kësaj seance, por Kryetari në fillim të kësaj seance tha se një seancë e tillë nuk mund të fillojë ngase nuk ka kuorum për mbajtjen e saj.[15] Duke interpretuar gabimisht Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, ai tha se po bën një përjashtim të vogël që nga një fjalë prej tre minuta të japë për kryetarët e grupeve parlamentare.

IKD vlerëson se kuorumi në seancë plenare është i domosdoshëm dhe i patejkalueshëm për votimin e projektligjeve dhe akteve të tjera të Kuvendit, por kuorumi nuk duhet të jetë pengesë për zhvillimin e debatit parlamentar, veçanërisht kur ajo është e thirrur nga një e treta e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, bashkësi deputetësh që me Kushtetutë kanë të drejtën e propozimit edhe të amendamenteve kushtetuese.

Praktika dhe interpretimi i tillë i Rregullores e mbyllet demokracinë parlamentare. Kryetari i Kuvendit e po ashtu edhe Kryesia e Kuvendit duhet të kenë parasysh situatat ku shumica parlamentare nuk merr pjesë në asnjë seancë të jashtëzakonshme, në asnjë debat parlamentar, në asnjë interpelancë dhe në asnjë komision hetimor të iniciuar nga opozita ose edhe anasjelltas.

IKD vlerëson se duhet të ketë prag minimal për t'u ndërprerë seanca kur nuk arrihet ta zëmë p.sh. 1/4 e të gjithë deputetëve, po jo shumicë e nevojshme e të gjithë deputetëve të Kuvendit për zhvillimin e debatit parlamentar.

10. Gjuha (jo) parlamentare

"...Është i pakuptimtë epshi juaj për të marrë vëmendjen publike, por kjo është e parëndësishme." "...për ofendimet personale të shefes së grupit parlamentar të VV-së, ish këshilltares së Bajram Rexhepit në PDK, të ndjerit, ish-nënkryetares së Behxhet Pacolli në AKR, ish-zëvendëskryeminstres së Hashim Thaçit në Qeveri, ish partneres së koalicionit dhe ish-deputetes së Isa Mustafës në LDK, dhe shefes aktuale të Grupit Parlamentar të Albin Kurtit, dhe nuk po flas për pesë persona, po flas për një, nuk mund t'i flas për një çështje që se kupton e që është moraliteti dhe kurrizi politik."

[15] "Transkript i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 4 shtator 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_09_04_ts_Seanca_YmmcDHad6J.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

“Jo si ju, deputetë të nderuar të opozitës, këtu në foltore jeni shqiptonjë, por kur shkoni nëpër ambasada, ktheheni në pula.”, “Phu të q*sha, tradhtari m*tit” “Mocionin e kombinuar me fjalim patetik Lumir Abdixhiku”[16] “...edhe lopa në grazhd e di se kush i ka hupur 8200 hektarë atje.”[17], “mshale gojën, magjup”[18], Albin, ti e rrejte veç veten”[19], “Nuk e keni idenë sa hipokritë jeni.” ky farë djali çka është duke kërkuar?, Mos u paraqit budalla, kur s’je, o vëlla! Nuk je i denjë të replikoj me ty... Nënë e motër e grua ia kishe çuar dikujt me t’i dhanë gjashtëmbëdhjetë milionë., “...se ky ka qejf me statistika të rrejë”, “qe një vit është duke rrejtur”, “...me çfarë lehtësie ky djaloshi po fol për këtë temë...” “A beson, po m’i kujton fëmijët e mi para dy-trembëdhjetë vjetësh kur kanë qenë të vegjël e thërrisnin prej toaletit “Babë, e bëra!”, kur shkoja, thoshin “Jo, s’e bëra! Fake alarm”. Alarm i rrejshëm. A e kupton? Domethënë, tërësisht. “E bëra, s’e bëra. E bëra, s’e bëra!” “...unë tash nuk e di gjuhën e bretkosave...”, “Ministre, për besë po më vjen marre të të them po rren, por seriozisht jeni duke rrejtur.”, “...rrugaç, majmun e laper”. “Na tregoni me këndë jeni në kontakt, me Vuçiqin, me Radojçiqin, apo me kë jeni në kontakt për mocionin, se mocionin pa Radojçiqa e Vuçiqa nuk mund ta bëni. Nëse i keni, tregoni që jeni në koordinim me ta, po nëse nuk jeni në koordinim, tregona.”, “kjo më tregon që përnjëmend edhe kapaciteti i saj për të kuptuar fenomenet politike është po ashtu i limituar dhe nuk po më duket kështu e befasishme për mënyrën qysh po flet, sepse për të ekzistenca politike është komplet e shpërfytyruar si ekzistencë biologjike.”, “statistikat manipuluese, që i thotë ky djaloshi.”, Përnjëmend këtë djalin këtu unë e njoh goxha moti, kështu e njoh goxha mirë edhe e di çfarë manipulanti është.”, “Hashim Haxhi Polari prej Broje!”, “...të flasim për gruan e frizerit, të flasim për lukun tend...” kanë qenë disa nga fjalitë që deputetët dhe kabineti qeveritar i ka shkëmbyer ndërmjet veti gjatë zhvillimit të seancave plenare dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës.

Gjuha e tillë e përdorur nga ana e deputetëve dhe nga ana e kabinetit qeveritar të cilat kanë përfshirë përdorimin e gjuhës seksiste, mizogjene, raciste dhe homofobe është e papërshtatshme dhe e papranueshme. Përdorimi i tillë i gjuhës joparlamentare nga përfaqësuesit e zgjedhur dhe ata të emëruar që kanë autorizime publike, minon parimet e barazisë, dinjitetit dhe respektit për të gjithë individët. Kur përfaqësuesit e zgjedhur përfshihen në një sjellje të tillë, kjo jo vetëm që reflekton keq tek ata personalisht, por gjithashtu dëmton besimin në procesin demokratik dhe mund të sjell pasoja në krijimin e stereotipave të dëmshme deri në diskriminim.

Gjuha e tillë e përdorur në Kuvendin e Kosovës, polarizimi i skajshëm ndërmjet deputetëve dhe grupeve parlamentare dhe po ashtu ndërmjet deputetëve dhe kabinetit qeveritar ishte kritikuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023. Në këtë raport thuhet se, gjatë vitit 2023, puna e Kuvendit të Kosovës është përcjellë nga një atmosferë e polarizuar politike dhe për më tepër debati në Kuvend përveç tensionimit, disa deputetë dhe

[16] Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_03_02_ts_Seanca_tK6hBcsfJt.pdf, fq.7.

[17] Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_02_23_ts_Seanca_qM3YphPKHF.pdf, fq.

[18] “Valentina Bunjaku e LDK-së i thotë “magjup” e “majmun” deputetit Adnan Rrustemi”. Koha, 22 qershor 2023. (Shih linkun Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_03_02_ts_Seanca_tK6hBcsfJt.pdf, fq.7.). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

[19] Shih linkun: Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_03_02_ts_Seanca_tK6hBcsfJt.pdf, fq.7.

anëtarë të kabinetit qeveritar përdorën gjuhë nxitëse, stereotipizim dhe gjuhë gjinore jo të ndjeshme.[20] Kjo mënyrë e sjelljes kishte ndikuar në rolin e dobët të Kuvendit si një vend i përfaqësuesve që ata të jenë shembull për dialog politik konstruktiv dhe për ndërtimin e konsensusit veçanërisht për tema jetike për vendin.

IKD gjen në një rast kur kryesuesja e seancës, nënkryetarja Saranda Bogujevci, jep vërejtjen ndaj zv.kryeministrit Besnik Bislimi dhe ndaj deputetëve për gjuhën joparlamentare. Në një rast, tjetër Kryetari i Kuvendit i tërheq vërejtjen zv.kryeministrit Besnik Bislimi për gjuhën seksiste të përdorur ndaj deputetes Ariana Musliu Shoshi.

10.1 Mospërmbajtja e një pjese të deputetëve në diskutimin mbi Projektligjin për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar mjekësor

Me sponsorizim të Ministrisë së Shëndetësisë, deputetëve të Kuvendit të Kosovës u është dorëzuar një projektligj i cili ka për qëllim adaptimin e praktikave më të mira evropiane të shëndetit riprodhues dhe fertilizimit të asistuar mjekësor. Sipas ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia, arsyeja pse është proceduar një projektligj i tillë është mungesa e legjislacionit adekuat, mungesa e burimeve njerëzore, mungesa e infrastrukturës dhe mungesa e financimit në sektorin publik. Ndërsa, sipas Memorandumit Shpjegues, një politikë e tillë është propozuar si një e drejtë riprodhuese e secilit individ kur kjo gjë nuk arrihet me shtatëzani të dëshiruar përmes rrugëve natyrore.

Me këtë projektligj nuk u pajtuan një pjesë e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, qëndrimet e të cilëve nuk mbështeteshin në argumente, por që sipas tyre projektligji bart të meta kushtetuese dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, por qëndrime të cilat përkojnë me sferën e moralit, se si një projektligj i tillë cenon familjen dhe vlerat e saj. Deputeti nga GP i LVV-së, Eman Rrahmani, nën këtë arsyetim kërkoi nga ministria që projektligji të tërhiqet nga procedura parlamentare.[21]

Ndonëse liria e shprehjes dhe mendimit është e garantuar me Kushtetutë, veçanërisht përfaqësuesit e zgjedhur janë të mbrojtur edhe nga çdo ndjekje penale apo civile, për qëndrimet që mbajnë dhe për mënyrën se si votojnë ata nuk mund t'i caktojnë vetes autorizime morale. Deputetët duhet të mbajnë qëndrime të cilat mund të gjejnë mbështetje në Kushtetutën e Kosovës, standardet ndërkombëtare të cilat janë të inkorporuara në nenin 22 të kësaj Kushtetute.

[20] "Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023", fq. 9, 2023, Komisioni Evropian. (Shih linkun https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf). (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

[21] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 9 mars 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_03_09_ts_Seanca_dPX6kntxad.pdf). (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

11. Dështimi i Kuvendit për miratimin e Kodit Etik

Në korrik të vitit 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi Rregulloren e re të Punës, ku në nenin 129 të saj parashihej miratimi i Kodit të Sjelljes së deputetit. Një kod i tillë ende nuk është miratuar, përkundër faktit se kanë kaluar me shumë se njëzet muaj nga hyrja në fuqi e Rregullores së Kuvendit.

IKD ka gjetur se Komisioni për Legjislacion ka formuar grupin punues për hartimin e Kodit Etik. Ky grup ka vizituar disa vende dhe ka hartuar draftin e parë të këtij kodi, por i njëjti ende nuk është dorëzuar formalisht në komision për t'u shqyrtuar dhe proceduar në Kuvendin e Kosovës.

Kuvendi i Kosovës duhet të ketë parasysh se me rastin e miratimit të një kodi të tillë që mjaftueshëm të përshkruajë natyrën e përgjithshme dhe të veçantë të sjelljeve joparlamentare të deputetëve dhe të shprehë vlerat e përbashkëta dhe parimet kryesore të cilat do ta orientonin dhe vlerësonin sjelljen e deputetëve. Po ashtu, në këtë kod duhet të përfshihen qartë dhe të parashihet në mënyrë të saktë zbatimin e tij në rastet kur shkelen dispozitat e këtij kodi.

12. Përfaqësuesit e qytetarëve me aktakuza

IKD ka identifikuar 12 deputetë (në mesin e tyre edhe ish-deputetë, tani ministra) që gjatë vitit 2023 janë përballur me ligjin. Në këtë numër prijnë deputetët e LVV-së, pastaj AAK-së dhe të PDK-së.

Deputetët e LVV-së: Valon Ramadani, Drita Millaku, Salih Zyba e Fitore Pacolli-Dalipi si dhe Xhelal Sveçla, akuzohen për dy vepra penale: "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm" dhe "Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare". Në aktakuzë thuhet se në seancën e Kuvendit të Kosovës, në cilësi të deputetit, Ramadani, Millaku, Zyba Pacolli-Dalipi dhe Sveçla kishin hedhur gaz lotsjellës në sallë, me ç'rast është pamundësuar qëndrimi në sallë.

Deputetët e PDK-së: Hajdar Beqa, Bekim Haxhiu dhe Mërgim Lushtaku përballen me akuzën për veprën penale "Sulmi", kurse deputeti Beqa akuzohet edhe për veprën penale "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë", përderisa Bekim Haxhiu akuzohet për veprën "Lëndim i lehtë trupor". [22]

Deputeti Artan Abrashi ngarkohet me veprën penale "Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare". Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, thuhet se Abrashi kishte sulmuar personat zyrtarë të cilët kanë qenë duke i kryer detyrat zyrtare lidhur me sigurinë e përgjithshme dhe ruajtjen e rendit publik.

[22] "Përleshja në Kuvend, aktakuzë ndaj Besnik Bislimit, Hajdar Beqës, Mërgim Lushtakut dhe Bekim Haxhiut." Betimi për Drejtësi, Tetor 2023. (Shih linkun <https://betimiperdrejttesi.com/perleshja-ne-kuvend-aktakuze-ndaj-besnik-bislimit-hajdar-beqes-mergim-lushtakut-dhe-bekim-haxhiut/>). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

Deputetja e GP të AAK-së, Time Kadrijaj, së bashku me ish-deputeten Teuta Haxhiun ngarkohen me veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”. Sipas aktakuzës, ato kishin mbajtur në posedim armë, në atë mënyrë që paraprakisht kanë siguruar armë që përdoret për shpërndarjen e gazit irritues.

Në një rast tjetër, deputeti i AAK-së Pal Lekaj u dënua për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, me 3 vjet e 8 muaj burgim efektiv. Ndaj tij, gjykata e shkallës së parë shpalli edhe dënim plotësues: ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në administratë publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 3 vite e 6 muaj.[23]

Ndërsa, deputeti i PDK-së Xhavit Haliti u dënua për veprën penale “Sulm”, me 1 mijë euro gjobë. [24]

12.1 Lirimi nga akuza për Kryetarin e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit ishte i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë për veprat penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”. Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli aktgjykim lirues ndaj tij më 26 shkurt 2024.[25]

Kryetari Glauk Konjufca ishte i akuzuar për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend. Sipas Gjykatës, nuk është provuar se Konjufca ka kryer veprën që i vihej në barrë “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, kurse për veprën penale “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare”, për të cilën ka arritur parashkrimi, është refuzuar akuza.

13. Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike në seancë plenare dhe në komisionet parlamentare

IKD gjatë monitorimit të punës së Kuvendit në seanca plenare ka gjetur se Kryeministri, anëtarët e Qeverisë dhe deputetët, duke bërë deklaratave publike kanë ndërhyrë në sistemin e drejtësisë.

Kryeministri i Kosovës Albin Kurti, duke bërë deklaratave në drejtim të kandidatit për Kryeprokuror të Kosovës, Blerim Isufaj, tejkaloi kompetencat e tij dhe cenoi rëndë parimet kushtetuese të ndarjes së pushteteve. Në seancën plenare më 20 prill 2023[26], ai tha se prokurori Blerim Isufaj dëshiron të bëhet kryeprokuror përkundër vullnetit të Presidentes, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit. Për më tepër, Kryeministri vazhdoi duke problematizuar disa lëndë në të cilat prokurori Blerim Isufaj ishte në krye të tyre, siç ishte rasti

[23] “Gjykata merr vendim në rastin e “53-milionëshit”, ish-ministri Pal Lekaj dënohet me 3 vjet e 8 muaj burgim efektiv”, Betimi për Drejtësi, 31 janar 2024. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-merr-vendim-ne-rastin-e-53-milioneshit-ish-ministri-pal-lekaj-denohet-me-3-vjet-e-8-muaj-burgim-efektiv/>). Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2024).

[24] “Xhavit Haliti dënohet me 1 mijë euro gjobë për sulm ndaj deputetit të LDK-së, Arben Gashit”, Betimi për Drejtësi, 22 janar 2024. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/xhavit-haliti-denohet-me-1-mije-euro-gjobe-per-sulm-ndaj-deputetit-te-ldk-se-arben-gashi/>). Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2024).

[25] “Glauk Konjufca lirohet nga akuza për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend”, Betimi për Drejtësi, 26 shkurt 2024. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/glauk-konjufca-lirohet-nga-akuza-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 10 janar 2024).

[26] “Transkript i seancës plenare të Kuvendit”, fq. 3 Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 prill 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_04_20_ts_Seanca_10.00_eeqKrjDquU.pdf). (Qasur për herë të fundit më 25 janar 2024).

me vdekjen e ish-shefit të AKP-së, Dino Asanajt, vdekjen e ish-drejtorit të informimit në Kryeministri, Hamdi Sopës, e të cilat, sipas Kryeministrit Kurti, prokurori nga vrasje i shndërroi në vetëvrasje.

Në lidhje me sfidimin e ligjeve në Gjykatën Kushtetuese, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu deklaroi se kjo gjykata është bërë aleat i opozitës. Ajo këtë deklaratë e dha gjatë diskutimeve me deputetët opozitarë në Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje.[27]

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi në mbledhjen e Komisionit për Integrim Evropian ku raportoi lidhur me përmbushjen e obligimeve të institucioneve në procesin e integritimit evropian, tha se për ligjin për KPK-në dy herë është marrë mendim pozitiv nga Komisioni i Venedikut. "Por ja që po del që Gjykata Kushtetuese e Kosovës mendon ndryshe nga Komisioni i Venedikut". Për më tepër, ai tha se si zëvendëskryeministër guxon t'i komentojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese.[28]

IKD vlerëson se detyrë e pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv nuk është të merren me organet e sistemit të drejtësisë e as me emrat e përveçëm. Këto dy pushtete duhet të jenë ndihmesë në realizimin e kërkesave ligjore e buxhetore të organeve të sistemit të drejtësisë dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë penguese. Ndërhyrjet e tilla përmes deklaratave, qoftë edhe në mungesë të qëllimit negativ që mund të kenë bartësit e pushtetit, ato shkaktojnë mosbesimin e qytetarëve në organet e drejtësisë.

14. Vonesat në zgjedhjen e organeve kolegjiale dhe individuale

Në sistemin tonë kushtetues, Kuvendi ka rol vendimtar për përzgjedhjen e një pjese të madhe të pozitive të rëndësishme në institucione të pavarura kushtetuese. Këtë rol ai e ushtron në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, duke presupozuar në përzgjedhjen e zyrtarëve adekuatë, prej të cilëve pritet që të jenë në krye të detyrës sepse funksionimi i atyre institucioneve do të bëhet nga ta. Në këtë drejtim, Kuvendi duhet të sigurohet që pozitën kyçe dhe të tjera të plotësohen përmes proceseve transparente dhe të përgjegjshme.

IKD kishte gjetur se gjatë vitit 2022 Kuvendi kishte dështuar në përzgjedhjen e dhjetëra zyrtarëve. Kuvendi nuk kishte arritur të emërojë pozita të rëndësishme në 18 organe, siç është rasti me dy gjyqtarët në Gjykatën Kushtetuese, tre anëtarë në Komisionin e Pavarur të Mediave, dy anëtarë në Komisionin e Pavarur të Konkurrencës, dy anëtarë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dy anëtarë në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Guvernatorin e BQK-së, Bordin e Fondit të Kursimeve Pensionale, Komisionin për Ndihmë Shtetërore etj.

[27] "Haxhiu: Kushtetuesja është bërë aleate me opozitën", Koha, 23 tetor 2023. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/396518/haxhiu-kushtetuesja-eshte-bere-aleate-me-opoziten>). (Qasur për herë të fundit me 25 janar 2024).

[28] "Procesverbal i mbledhjes së Komisionit për Integrim Evropian", Kuvendi i Republikës së Kosovës, 10 maj 2023. (Shih linkun https://www.assemblyofkosovo.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_60_dt_10_05_2023_KIE_FnYUSUa5bJ.pdf). (Qasur për herë të fundit me 25 janar 2024).

Gjatë vitit 2023, Kuvendi zgjodhi pjesën më të madhe të pozitive që nuk arriti t'i bëjë në vitin paraprak, përveç emërimit të një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese, dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e gjinisë femërore dhe një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb, si dhe tre anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.

15. Dështimet e njëpasnjëshme për zgjedhjen e një anëtari në KGJK

IKD gjen se procesi i votimit për një anëtar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës u përshkua nga mungesa e kuorumit në disa seanca. Në anën tjetër, Kuvendi u përball edhe me dilemat ligjore në lidhje me atë se sa është kuorumi i nevojshëm për t'u zgjedhur një anëtar në KGJK.[29] Në lidhje me çështjen e votave të nevojshme për t'u zgjedhur anëtar në KGJK, kjo gjë shihet qartë edhe në Ligjin për KGJK-në.[30] Në raundin e parë, njëri nga kandidatët duhet t'i marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, e nëse nuk arrihet kjo gjë atëherë në raundin e dytë konsiderohet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave. Për më tepër, në këtë seancë Kuvendi dështoi të zgjedhë një anëtar, ngase asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk mori votat e nevojshme për t'u zgjedhur.[31] Vetëm në muajin e fundit të vitit 2023, Kuvendi arriti që të zgjedhë njërin nga kandidatët e propozuar për anëtarë në KGJK. Më 15 dhjetor 2023, Kuvendi zgjodhi Artan Abazin për anëtar në KGJK.

16. Transparenca e Kuvendit

Kuvendi ka vazhduar publikimin e informatave elementare sa i përket punës së trupave të këtij institucioni. Në mënyrë të rregullt dhe me kohë publikohen procesverbalet e Kryesisë së Kuvendit dhe informacionet e tjera bazike të Kryetarit, nënkryetarëve, kryetarëve të grupeve parlamentare, deputetëve dhe kryetarëve të komisioneve parlamentare. Por, këto aspekte siç e theksuam janë elementare.

IKD gjen se Kuvendi në fusha të caktuara ka vazhduar të përballet me mungesë të transparencës. Që nga publikimi i gjetjeve në Raportin për punën e Kuvendit gjatë vitit 2022[32] nuk është bërë lëvizje e duhur dhe pozitive në drejtim të publikimit të të gjitha materialeve me rastin e mbajtjes së një seance parlamentare. Ftesa dhe rendi i ditës publikohen, por nuk janë të qasshme materialet në lidhje me mbledhjen e caktuar. Në të gjitha rastet, vazhdojnë të mos publikohen mocionet përmbajtësore të grupeve parlamentare, nuk janë të publikuara rekomandimet e komisioneve për projektligje dhe për zgjedhjen e organeve individuale dhe kolegjiale.

IKD gjen se komisionet parlamentare i mbajnë mbledhjet e hapura, por të njëjtat vazhdojnë të mos transmetohen përmes faqes zyrtare të Kuvendit përmes Radio Televizionit të Kosovës ose edhe përmes ndonjë entiteti tjetër siç janë agjencitë e lajmeve.

[29] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit", fq. 49 dhe 50. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2 shkurt 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_02_02_ts_Seanca_ENMCLTtep6.pdf).

[30] "Paragrafi 9 dhe 10 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës", Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18335>). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

[31] "Përsëritet konkursi për një anëtar të KGJK-së, kandidatët s'marrin votat e mjaftueshme". Betimi për Drejtësi, 2 shkurt 2023. (Shih linkun <https://betimiperdrejttesi.com/perseritet-konkursi-per-nje-anetar-te-kgjk-se-kandidatet-smarrin-votat-e-mjaftueshme/>). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

Rrjedhimisht, përkundër faktit se këto mbledhje janë të hapura për mediat, publiku i gjerë nuk ka qasje në këto takime, në rastet kur të njëjtat nuk mbulohen nga mediat. Në anën tjetër, përkundër miratimit të Planit të Veprimit për Kuvend të Hapur 2023-2026, ku janë listuar të gjitha veprimet që Kuvendi të përmirësojë qasjen në informacion, të lehtësojë pjesëmarrjen e qytetarëve, mediave dhe OShC-ve në punën e Kuvendit, në rritjen e llogaridhënies, digjitalizimi dhe avancimin e teknologjisë informative një gjë e tillë nuk është arritur në mënyrë të kënaqshme.

17. Dështimi i vazhdueshëm për të siguruar votimin elektronik të deputetëve

Kuvendi përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur të popullit i cili duhet të kujdeset për zbatimin e standardeve më të lartë të transparencës. Sepse vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet deri te qasja e barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës për të marrë informacionin e duhur për mënyrën se si përfaqësuesit e zgjedhur i përfaqësojnë interesat e qytetarëve. Por, këto standarde vazhdojnë të mos aplikohen edhe në vitin e katërt të kësaj legjislature.

Kuvendi vazhdon të dështojë në sigurimin e votimit elektronik të deputetëve për secilin aktivitet gjatë punës në seancat plenare. Në anën tjetër, si pasojë e mungesës së votimit elektronik, shpesh herë ndodh që numërimi i votave të mos jetë i saktë dhe të përsëritet në më shumë se dy herë dhe sërish të mos jetë i qartë në fund rezultati.[33]

Në këtë mënyrë, Kuvendi ka vazhduar të zhvillojë punime në seanca parlamentare duke përdorur votimin me dorë, sepse ai elektronik nuk arrin të funksionalizohet përkundër faktit që edhe shefi i kabinetit të Kryetarit të Kuvendit pati njoftuar publikisht në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook për një lajm të "mrekullueshëm" për Kuvendin në lidhje me zotimin e stafit të Ambasadës së Luksemburgut, respektivisht zotimit të ambasadorit Eric Dietz për mbështetje nga LuxDev për renovimin dhe vendosjen e pajisjeve të reja për votim elektronik në sallën plenare.[34]

Për shkak të mungesës së votimit elektronik, qytetarët, shoqëria civile dhe secili grup i interesit që mund të jetë i interesuar nuk mund ta dijë se për një çështje të caktuar si ka votuar një deputet në mënyrë që ta mbajë përgjegjës në ditën kur mbahen zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

Me 28 korrik 2022, Kuvendi ka miratuar Rregulloren e re, e cila në raport me transparencën veçanërisht në lidhje me publikimin e votës së deputetëve kërkon që ai të bëhet publik menjëherë pas përfundimit të seancës plenare. Një gjë e tillë nuk praktikohet edhe pse sipas kësaj rregulloreje, nëse votimi bëhet me dorë, atëherë publikimi i votimit me dorë bëhet publike brenda dy (2) ditë pune pas përfundimit të votimit në seancë plenare.[35] Edhe pse obligative, ajo nuk ka gjetur zbatim në praktikë.

[32] JAKAJ N. Dobët: *Raport i monitorimit të punës së Kuvendit për vitin 2022*, Instituti i Kosovës për Drejtësi, IKD 2023. (Shih linkun: <https://kll-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/DOBET-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2022.pdf>). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

[33] *Shih për më shumë votimin me dorë në rastin e votimit në lexim të parë të Projektligjit për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizimin e Asistuar Mjekësor të mbajtur në seancën plenare të datës 9 mars 2023 me ç'rast votimi u përsërit dy herë për shkak të paqartësisë se sa vota u morën në votimin e parë dhe sa vota në votimin e dytë. Shih faqen 60 dhe 61 të seancës plenare në këtë link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_03_09_ts_Seanca_dPX6kntxad.pdf. Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.*

[34] "Postim në facebook: Një lajm i mrekullueshëm për Kuvendin e Republikës së Kosovës", 19 maj 2023. (Shih linkun: https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=10159782823924635&id=567589634&mibextid=oFDknk). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

Si rrjedhojë, përkundër angazhimit maksimal të Kuvendit për miratimin e rregullores së re, përkundër miratimit të planit të veprimit, Kuvendi nuk ka arritur të funksionalizojë votimin elektronik dhe për më tepër nuk ka zbatuar dispozitat që e obligojnë atë që deri në funksionalizimin e këtij sistemi të publikojë në secilin rast rezultatet e “votimeve me dorë”.

IKD kërkon me urgjencë nga Kuvendi që të angazhohet maksimalisht në vendosjen e votimit elektronik, sepse vetëm në këtë mënyrë rritet efikasiteti dhe transparenca. Në anën tjetër, në pajtim me Rregulloren e Punës, Kuvendi duhet të bëjë të ditur rezultatet e “votimit manual” në secilin rast derisa votimi elektronik të jetë funksional.

18. Dështimi i Kuvendit për t'i publikuar materialet e komisioneve hetimore parlamentare

Sigurimi i llogaridhënies, ruajtja e besimit të publikut dhe mbrojtja e vlerave demokratike varen në mënyrë të veçantë edhe nga transparenca në mbledhjet e komisioneve hetimore parlamentare. Të gjitha KHP-të të themeluara në Legjislaturën VIII nuk kanë respektuar në masë të madhe këto parime, duke nisur nga transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve dhe nga mospublikimi i procesverbaleve dhe transkripteve.

Ligji për Hetim Parlamentar në asnjë dispozitë të tij nuk ndalon publikimin e dokumenteve për të cilat është mbajtur mbledhje publike. Ky ligj ka specifikuar në mënyrë të qartë dhe të saktë se kur komisioni mban mbledhje të mbyllura për të cilat në fazë të mëvonshme nuk është i obligueshëm publikimi i procesverbalit dhe mbledhjeve.

IKD vlerëson se një qasje e tillë e Kuvendi nuk është në shërbim të interesave mbi të cilat funksionon. Hapja dhe transparenca duhet të jenë gurthemel i punës së organeve hetuese parlamentare. Kjo përfshin sigurimin e publikut me qasje të lehtë në informacionin mbi mandatin, procedurat, seancat dëgjimore dhe konkluzionet e komisionit nëpërmjet kanaleve formale, siç janë njoftimet për medie, publiciteti i mbledhjeve dhe dokumentacioni i vendosur në faqen zyrtare të Kuvendit.

KHP-të mund të kryejnë me sukses detyrën e tyre, të mbajnë përgjegjësi institucionet qeveritare dhe të mbështesin avancimin e qeverisjes demokratike vetëm duke iu përmbajtur normave të transparencës.

19. Aktiviteti legjislativ

Aktiviteti legjislativ gjatë vitit 2023 u përshkua nga mosefikasiteti i Kuvendit në miratimin projektligjeve dhe pikave të tjera të rendit të ditës, sipas rendit të ditës për të cilin Kryesia e Kuvendit kishte vendosur në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare.

[35] “Neni 61, paragrafi 9, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës”, 2022, Gazeta Zyrtare e Kosovës. (Shih linkun <https://gzk.rksgov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkg1E5EcTI3ZFBSGcbPz0Vh5lt7ysr9nvzgmndq-6nYhvjjjBQF00qKQ>). (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

Përgjithësisht, ndikim pati mungesa kronike e kuorumit që në shumicën e rasteve u shkaktua nga deputetët e shumicës parlamentare, veçanërisht te projektligjet ku kërkohet shumicë e thjeshtë e votës. Në anën tjetër, edhe këtë vit, përveç në masë më të madhe, u shfaq fenomeni i mosvotimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për të cilat në procesin e vendimmarrjes nuk merrnin pjesë deputetët e opozitës parlamentare.

Te marrëveshjet ndërkombëtare, IKD vlerëson se deputetët nuk mund të mos i votojnë për arsye politike, përveç arsyeve të cilat mund të jenë të karakterit që një marrëveshje e tillë e vendos Kosovën në obligime financiare ose për çështje të tjera në kundërshtim me interesin publik. Nga marrëveshjet që janë propozuar nga ana e Qeverisë së Kosovës, vërehet që shumica e tyre janë marrëveshje që kanë për qëllim interesin publik dhe jetik të qytetarëve në fushën e arsimit, infrastrukturës rrugore, ujore në fushën e mjedisit. Në këtë drejtim, deputetët duhet të arrijnë konsensus dhe t'i japin përparësi interesave të qytetarëve.

Nga monitorimi që IKD i bën Kuvendit, gjen se gjatë vitit 2023 janë miratuar 71 projektligje, ndërsa pesë projektligje nuk janë miratuar.

·71 projektligje të miratuara
·5 projektligje të refuzuara nga Kuvendi

Projektligjet që u refuzuan nga shumica parlamentare kishin të bënin me projektligje që u propozuan nga opozita parlamentare që për qëllim kishin ndryshimet në fondet pensionale të Kosovës dhe ndryshimet në skemat pensionale të financuara nga shteti. Projektligj tjetër që nuk u mbështet nga grupi më i madh parlamentar kishte të bënte për pensionet e zyrtarëve policorë të Policisë së Kosovës dhe punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore. Ndërsa, opozita votoi kundër Marrëveshjes Ndërkombëtare për financimin në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin - Projekti i reformës së sistemit të ndihmës sociale në Kosovë.

Në Gjykatën Kushtetuese përfunduan për t'u vlerësuar kushetutshmëria e tyre tetë projektligje dhe një vendim i Kuvendit, procedura të cilat në masë të madhe u iniciuan nga opozita parlamentare dhe një nga Avokati i Popullit.

Nr.	Titulli i ligjit	Parashtruesi	Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese
1.	Ligji nr.08/L-121 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme	Partia Demokratike e Kosovës	Në pritje të vendimit
2.	Ligji nr.08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficentit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	Në pritje të vendimit
3.	Ligji nr.08/L-180 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	1. Partia Demokratike e Kosovës 2. Lidhja Demokratike e Kosovës	Në pritje të vendimit
4.	Ligji nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme	Komuna e Prizrenit	Në tërësi në përputhje me Kushtetutën Aktgjykimi: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/11/ko_177_23_agj_shq.pdf

5.	Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovë	Avokati i Popullit	Në pritje të vendimit
6.	Ligji nr.08/L-238 për Fondin Sovran të Republikës së Kosovës	Partia Demokratike e Kosovës	Në pritje të vendimit
7.	Ligji nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme	Partia Demokratike e Kosovës	Në pritje të vendimit
8.	Seanca e datës 13 korrik 2023	Partia Demokratike e Kosovës	Aktvendim për papranueshmëri
9.	Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti	Avokati i Popullit	Në pritje të vendimit

Tabela nr. 3 - Numri i ligjeve të dërguara në GjK dhe vendimmarja e GjK-së

Përkundër që i ka shqyrtuar, gjatë vitit 2023 Kuvendi nuk arriti t'i miratojë gjashtë marrëveshje ndërkombëtare, tri projektligje në lexim të dytë dhe shtatë projektligje në lexim të parë. Këto projektligje janë bartur për shqyrtim dhe votim në sesionin pranveror në vitin 2024.

Sa i përket propozuesve të projektligjeve, numrin më të madh të projektligjeve e ka proceduar Qeveria e Kosovës përderisa deputetët propozuan miratimin e tri projektligjeve. Edhe pse gjatë kësaj legjislature, veçanërisht në vitin 2022 kishte një dinamikë, ku u propozuan dhjetë projektligje, iniciativa të grupeve parlamentare opozitare, në vitin 2023 siç shihet bie ky intensitet.

20. Mungesa e bashkëpunimit të shumicës parlamentare në adresimin e kërkesave buxhetore të deputetëve opozitarë në ndarjet buxhetore vjetore për vitin 2024

Ligji mbi ndarjet buxhetore është ligji më i rëndësishëm i një shteti i cili tregon planin financiar të detajuar për të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara për vitin e ardhshëm fiskal. Shpenzimet kapitale, shpenzimet për shërbimet sociale, për sigurinë publike, infrastrukturën, kujdesin shëndetësor dhe arsimin janë çështje që adresohen përmes ndarjeve që sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kujdestare dhe përpiluese e këtij ligji.

Ligji mbi ndarjet buxhetore është ligji më i rëndësishëm i një shteti i cili tregon planin financiar të detajuar për të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara për vitin e ardhshëm fiskal. Shpenzimet kapitale, shpenzimet për shërbimet sociale, për sigurinë publike, infrastrukturën, kujdesin shëndetësor dhe arsimin janë çështje që adresohen përmes ndarjeve që sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kujdestare dhe përpiluese e këtij ligji.

IKD gjen se me rastin e procedimit të Projektligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2024, asnjë nga amendamentet e propozuara në buxhetin vjetor të parashtruara nga deputetët e opozitës nuk janë votuar. Nga 54 amendamente të propozuara, asnjëri nuk mori votat e mjaftueshme për të kaluar.

IKD vlerëson se, me rastin e miratimit të buxhetit vjetor, shumica parlamentare duhet të ketë parasysh se në sistemet demokratike përveç saj, edhe opozita luan rol kyç në procesin buxhetor. Shumica parlamentare duhet të gjejë mënyra se si opozita të përfshihet në ndarjet buxhetore vjetore të një shteti. Fillimisht, kjo duhet të bëhet duke i konsultuar dhe debatuar para se projektligji të miratohet në Qeveri. Një praktikë e tillë ka ekzistuar në kohën sa ishte ministër Bedri Hamza. Më tutje, shumica parlamentare duhet të negociojë dhe të bëjë kompromise me opozitën për amendamentet që mund të kenë ndikim për jetën e qytetarëve në mënyrë që të akomodohen shqetësimet e tyre.

21. Kuvendi vazhdon të dështojë në shqyrtimin e iniciativave qytetare

Deputetëve të Kuvendit të Kosovës u është shpërndarë një nismë legjislative e mbi 10 mijë qytetarëve më 28 tetor 2021, e cila më pas është shqyrtuar në parim në komisionin funksional me vonesë njëvjeçare (5 tetor 2022), përderisa është radhitur për shqyrtim edhe votim në seancën plenare më 27 tetor 2022.

Me iniciativën legjislative të mbi 10 mijë qytetarëve të Kosovës, Kuvendit të Kosovës i është servuar një projektligj i cili për qëllim kishte faljen e masave ndëshkimore që ishin zbatuar gjatë shpërthimit të COVID-19 dhe procedurën që duhej ndjekur që këto masa të faleshin.

Përfaqësuesi i nismës legjislative kishte njoftuar Kryetarin e Kuvendit dhe Kryesinë për vullnetin e tij që ai ta shpallë projektligjin para deputetëve, pasi që sipas tij, një mundësi e lë edhe Ligji për Nisma Legjislative.^[36] Por, Kryesia e Kuvendit kishte vendosur që përfaqësuesit të nismës t'i kërkojë që të propozojë ndonjërin nga 120 deputetët që këtë nismë legjislative ta shpallë para deputetëve dhe kabinetit qeveritar. Një gjë e tillë ishte kundërshtuar nga përfaqësuesi i nismës duke kërkuar që kjo çështje të kthehet në rivendosje. Një çështje e tillë ende nuk është riadresuar në Kryesinë e Kuvendit, duke e lënë këtë projektligj në pritje.

IKD vlerëson se në këtë mënyrë është injoruar përfaqësuesi i nismës legjislative, respektivisht mbi 10 mijë qytetarë të cilët kanë dhënë nënshkrimin e tyre për t'u shqyrtuar Projektligji nr. 08/L-062 për faljen e masave ndëshkimore të vendosura gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.

Injorimi i tillë është i dëmshëm për idealet që bart demokracia dhe për pjesëmarrjen qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Injorimi në këtë mënyrë i qytetarëve i bën ata më pak të angazhuar në shoqëri dhe me shumë gjasa që ata herëve të tjera të mos jenë pjesë e këtij lloji të aktiviteteve.

[36] "Neni 20, paragrafi 5, Ligji për Nisma Legjislative", 2010, Gazeta Zyrtare e Kosovës. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2776>). (Qasur për herë të fundit më 18 janar 2024).

Institucioni i Kuvendit të Kosovës, në këtë rast Kryesia e Kuvendit, duhet të ketë parasysh se propozimet që vijnë nga qytetarët përbëjnë interes dhe gatishmëri për të marrë pjesë në qeverisjen nacionale. Në rast të kundërt, kur këto nisma shpërfillen, qytetarët mund të zhgënjehen dhe të humbasin besimin në sistemin demokratik.

Kryetari i Kuvendit dhe Kryesia duhet të kenë parasysh se injorimi i nismave legislative nga qytetarët shpërfill shqetësimet dhe interesat e qytetarëve që ata supozohet t'i përfaqësojnë. Kjo mund të krijojë një shkëputje midis zyrtarëve të zgjedhur dhe publikut të cilit i shërbejnë, duke gërryer themelet e demokracisë përfaqësuese.

IKD kërkon nga Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit që të lejojnë përfaqësuesin e nismës legislative që të prezantojë me nismën, ngase moslejimi i përfaqësuesit do të thotë dështim për t'u mundësuar qytetarëve shprehjen e vullnetit të tyre. Në këtë mënyrë, Kryetari dhe Kryesia mund të perceptohen si të papërgjegjshëm ose indiferentë ndaj nevojave të zgjedhësve të tyre. Vetëm mbajtja përgjegjës e zyrtarëve të zgjedhur për adresimin e shqetësimeve të qytetarëve është esenciale për ruajtjen e besimit në institucionet demokratike.

22. Kushtëzimi jokushtetues dhe joligjor për votimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare

Për shkak të mospjesëmarrjes së deputetëve të opozitës në më shumë se pesë herë në procesin e votimit të Marrëveshja e financimit në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për "Projektin e reformës së sistemit të ndihmës sociale në Kosovë", ky projektligj iu nënshtrua procesit jo të rregullt të dialogimit me grupin parlamentar të PDK-së.

GP i PDK-së kushtëzoi votimin e kësaj marrëveshjeje në atë mënyrë që një pjesë e këtyre mjeteve të destinohen për vërshimet e ujit që ndodhën më 19 janar 2023 në komunat Skenderaj, Mitrovicë, Istog dhe Klinë. Më 23 mars, shumica parlamentare votoi këtë marrëveshje me ndihmën e deputetëve të GP të PDK-së.

IKD fillimisht vlerëson se procedura e ndjekur për miratimin e kësaj marrëveshjeje në Kuvendin e Kosovës është në pajtim me Kushtetutën dhe me Ligjin për Marrëveshjen Ndërkombëtare. Por, ajo nuk mund t'i nënshtrohet negocimit të qëllimit dhe synimit për çka është arritur ndërmjet palëve.

Në asnjë moment, marrëveshja ndërkombëtare financiare që është negociuar më parë nga MFPT ka pasur për qëllim tjetër objekt dhe amendamentimin e marrëveshjeje nuk mund ta bëjë Kuvendi përveç të drejtës në pjesën tekstuale të projektligjit por në asnjë rrethanë në amendamentimin e marrëveshjes.

Për më tepër, kujdesi i Qeverisë ndaj qytetarëve nuk duhet të bëhet pjesë e negocimit. Qeveria, sipas Kushtetutës, ka për detyrë të kujdeset për secilin qytetar të Kosovës dhe jo të zotohet për ndarjen e mjeteve me një marrëveshje ndërkombëtare.

23. Komisioni për Legjislacion nuk respektoi Rregulloren e Kuvendit

Ndryshimet që u bënë me rastin e miratimit të Rregullores së re të Kuvendit përfshinin atë që ndarjet buxhetore të shqyrtohen me procedurë të veçantë në raport me projektligjet e tjera, si dhe që në trajtimin e këtyre ndarjeve të përfshihen të gjitha komisionet parlamentare në raport me funksionet dhe përgjegjësitë mbikëqyrëse.

Aplikimi i dispozitave të tilla u bë menjëherë në vitin pasues për ndarjet buxhetore për vitin 2023. Komisionet parlamentare e shqyrtuan buxhetin sipas fushave që mbulojnë. Në shqyrtim morën pjesë ministritë përkatëse dhe përfaqësuesit e tjerë të organizatave buxhetore.

Një gjë e tillë u aplikua në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022 në Komisionin për Legjislacion, ku u shqyrtua buxheti për institucionet e drejtësisë dhe ku të pranishëm ishin Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, Avni Mehmeti nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Haki Gecaj nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Yll Buleshkaj nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) dhe Enver Fejzullahu nga Akademia e Drejtësisë (AD).

E njëjta nuk u aplikua me rastin e shqyrtimit të ndarjeve buxhetore për vitin 2023. Edhe pse u vendos në rend të ditës shqyrtimi i buxhetit nga fushëveprimi i Komisionit, nuk u ftuan përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë.^[37] Komisioni veproi në kundërshtim me nenin 81 të Rregullores së Kuvendit ku ministri përkatës dhe përfaqësuesit e tjerë të organizatave buxhetore duhet të marrin pjesë dhe të japin shpjegimet përkatëse.

IKD vlerëson se Kuvendi është vendi ku sipas Kushtetutës përveç autorizimeve për të miratuar ligjet, këtij insitucioni i janë dhënë edhe autorizime për të dëgjuar kërkesat e institucioneve të pavarura të cilat pa mbështetjen buxhetore të nevojshme nuk mund të funksionojnë më mënyrë objektive.

24. Kuvendi evitoi dëmtimin e mundshëm dhe të pariparueshëm të fondeve të kursimeve pensionale

Më 19 janar 2023, Kuvendi shqyrtoi nismën legjislative të 21.398 qytetarëve të Kosovës, të cilët propozuan tërheqjen e një pjese të kursimeve pensionale. Sipas ligjit të propozuar, që me autorizim përfaqësohej nga deputeti Bekim Haxhiu, qëllimi ishte që kontributpaguesit kosovarë të mund të tërhiqnin nga dhjetë (10) deri tridhjetë (30) për qind (%) të kursimeve të tyre pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës varësisht shumës që ata kanë mbledhur ndër vite.

[37] Procesverbal i Mbledhjes së Komisionit për Legjislacion..., Kuvendi i Kosovës, 23 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_93_dt_23_11_2023_KLMI_gu9AVBJf8f.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

Arsyetimi i mëtutjeshëm i propozuesit mbështetëj në faktin e detyrimit kushtetues që ka Qeveria dhe Kuvendit në promovimin dhe garantimin e mirëqenies së qytetarëve dhe se kjo mirëqenie është rrezikuar nga pasojat e krizës ekonomike gjatë vitit 2021 dhe 2022.

Kuvendi nuk e miratoi këtë nismë legislative[38], rrjedhimisht ruajti kursimet pensionale të cilat sipas Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale[39] të Kosovës këto mblidhen që njerëzit të kenë një burim të ardhurash pasi t'i mbushin 65 vite në mënyrë që më tutje të kenë një standard të arsyeshëm jetese pas daljes në pension dhe për të paguar shpenzimet e jetesës dhe kujdesin shëndetësor. Këto të ardhura janë thelbësore dhe në secilin shtet me demokraci të konsoliduar dhe me shtet të së drejtës sociale mirëmbahen dhe ruhen në mënyrën më të duhur.

I njëjti projektligj me të njëjtën përmbajtje dhe me propozues deputetin Bekim Haxhiu ishte refuzuar nga Kuvendi i Kosovës.

25. Shkelja e standardeve minimale të konsultimit publik për koeficientin e pagave

Në vitin 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi dy ligjet më të rëndësishme të reformës në administratën publike, Ligjin për Pagat në Sektorin Publik dhe Ligjin për Zyrtarët Publikë. Përmes Ligjit për pagat u caktuan koeficientet për më shumë se 80 mijë punonjës të administratës publike, por me këtë ligj nuk u përcaktua vlera e koeficientit përmes të cilit do të përlllogaritej paga e secilit punonjës. Kjo çështje u bë përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2023.

Projektligji nuk iu nënshtrua konsultimeve publike siç e ka për obligim Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në bazë të Rregullores Nr. 05/2016 për standardet minimale të konsultimit publik. Përkundër kësaj, projektligji në lexim të dytë u miratua me procedurë të përshpejtuar brenda një dite[40], duke mos marrë për bazë që me Rregulloren e Kuvendit parashihen edhe aktivitete që do t'i shërbenin në të mirë përmbajtjes së projektligjit, siç janë dëgjimet publike legislative.

26. Miratimi i ndryshimeve në Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në kundërshtim me Kushtetutën dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese

Më 10 tetor 2023, Kuvendi miratoi në parim Projektligji nr. 08/L-180 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.[41]

[38] "Vendim Nr. 08-V-461", Kuvendi i Kosovës, 19 janar 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/178Vendim_Beu2hYdY6L.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

[39] "Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale", Gazeta Zyrtare e Kosovës, 6 prill 2012. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2815>). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

[40] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 9 shkurt 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_02_09_ts_Seanca,ora20.00_ydxrVdnX9U.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

[41] "Vendim Nr. 08-V-615", 10.10.2023, Kuvendi i Kosovës. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/180Vendim_bj9rF5p9Wh.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

IKD, në analizën e vet të publikuar në tetor të vitit 2022 pati gjetur se projektligji i propozuar në tërësinë e tij është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cenon dhe e bën të parëndësishëm rolin e një institucioni kuazigjyqësor i cili kujdeset për mbrojtjen e standardeve në fushën e shërbimit civil, miratimi i një projektligji të tillë, efektivisht i bën pa mbrojtje dhjetëra mijëra shërbyes civilë.

IKD, raportin e dërgoi tek të gjithë deputetët para se projektligji të miratohej në lexim të parë dhe në lexim të dytë. Po ashtu, IKD i njoftoi deputetët për Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO171/18 ku nene të caktuara që u dërguan për vlerësim nga Avokati i Popullit u vlerësuan në pajtim me Kushtetutën e Kosovës. Avokati i Popullit e cilësoi si jokushtetues paragrafin 3 të Nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sa i përket gëzimit të imunitetit nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit në lidhje me vendimmarrjen e tyre.[42] Por, GJK këtë çështje e shpalli në pajtim me Kushtetutën.[43] Në ndërkohë, qeveria solli projektligj ku imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimin propozon ta heqë propozon ta heqë nga ligji bazik.

Përkundër raportit të IKD-së dhe vënies në dijeni të aktgjykimit të GJK-së, deputetët e Kuvendit të Kosovës miratuan ligjin me 23 tetor 2023, por që i njëjti u kontestua në Gjykatën Kushtetuese nga GP i PDK-së për të cilin deri në shkrimin e këtij raporti nuk ka ndonjë vendimmarrje.

27. Injorimi i komenteve të shoqërisë civile për Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme

Për dallim nga legjislaturat e kaluara, në këtë aktualen u ndërmor iniciativë serioze për të bërë reformën zgjedhore. Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin ad hoc i cili për qëllim do të kishte përpilimin dhe finalizimin e projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme, mbi të metat që kishte ligji bazik dhe mbi bazën e komenteve që kishte dërguar ambasadat e ndryshme në Kosovë, Bashkimi Evropian dhe shoqëria civile.

Reforma zgjedhore në Kosovë ka kohë që është kërkuar, por për arsye të mosmospajtimeve ndërmjet partive politike, një reformë e tillë nuk arrihej deri në fund. Në të kaluarën, Projektligji për zgjedhjet e përgjithshme është proceduar më shumë se tri herë në Kuvend, por asnjëherë nuk kishte arritur në pikën përfundimtare për miratim në seancë plenare.

IKD gjen se, më 8 qershor 2023, Kuvendi votoi projektligjin në parim, me gjithsej 86 deputetë të pranishëm dhe që votuan për, dhe në një seancë të dytë me 79 vota për, Kuvendi miratoi këtë projektligj edhe në shqyrtim të dytë. Votimi i tij u bë me procedurë të përsheptuar.

[43] "Paragrafi 3 i Nenit 11 i Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës", Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17745>). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

[39] "Aktgjykim KO171/18, 20 maj 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. (Shih linkun: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/05/ko_171_18_agj_shq.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

IKD po ashtu gjen se Kuvendi nuk pati parasysh vërejtjet e shoqërisë civile për këtë ligj, nuk mori parasysh vërejtjet dhe komentet e Avokatit të Popullit.

Një reformë të tillë e ka përkrahur OSBE-ja, e cila ka theksuar se janë krenarë që kanë mbështetur komisionin ad hoc për reformën zgjedhore dhe Kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca.[44] Miratimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme e ka përkrahur edhe Bashkimi Evropian[45],

Nën arsyetimin për shkelje kushtetuese sa i përket përfaqësimit të barabartë gjinor në listat zgjedhore, rrjedhimisht edhe në Kuvendin e Kosovës, Avokati i Popullit shfrytëzoi të drejtën e dërgimit të këtij ligji në Gjykatën Kushtetuese.[46]

28. Abuzimi/keqpërdorimi i shmangieve nga afatet procedurale

Kuvendi vazhdoi të shmang procedurat e rregullta të shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve. Nga monitorimi që ka bërë IKD, rezulton se Kuvendi rriti procedurat e shmangies në raport me vitin 2022. Gjatë vitit 2023, Kuvendi përdori procedurat e shmangies në 22 raste, pesë raste më shumë se sa në vitin 2022. Të gjitha propozimet erdhën nga grupi parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!

Propozimet për shmangie të procedurave përfshinin çështje që lidheshin me vendime të Qeverisë për masat emergjente në furnizimin e energjisë, çështje që lidheshin me ndarjet buxhetore për vitin 2023, më tutje ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personat e dhunuar gjatë luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre.

Përmes shmangies është votuar reforma zgjedhore, ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për minierat dhe mineralet, ratifikimi i një anëtari të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Agjencinë Kosovare të Akreditimit, miratimi i Ligjit për çmimin e produkteve medicinale, ndryshimet në skemat pensionale si rezultat i Aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese.

Më tutje, përmes shmangies Kuvendi ka miratuar edhe ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Zyrtarët Publikë.

Me shmangie është shqyrtuar edhe kërkesa e kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale për caktimin e taksave vjetore për vitin 2024, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-257 për administrimin e procedurave tatimore, shqyrtimi i dytë i Projekt-Kodit doganor dhe të akcizave

[44] "Postim në rrjetin social X", OSCE. (Shih linkun https://twitter.com/OSCEKosovo/status/1666830921599680512?ref_src=twsrc%5Etfw%7Ctwcamp%5Etweetembed%7Ctwterm%5E1666830921599680512%7Ctwgr%5EF9e10e13e753241b9ee90c1baadda780e94754a3%7Ctwcon%5Es1_&ref_url=https%3A%2F%2Fkallxo.com%2Fflajm%2Fosbe-pergez-on-kuvendin-e-kosoves-per-miratimin-e-ligjit-per-zgjedhjet-e-pergjithshme%2F). (Qasur për herë të fundit me 15 shkurt 2024).

[45] "Miratohet Ligji për zgjedhjet, BE-ja e duartroket e shoqëria civile e kritikon". Koha. (Shih linkun <https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/380945/miratohet-ligji-per-zgjedhjet-be-ja-e-duartroket-e-shoqeria-civile-e-kritikon>). (Qasur për herë të fundit me 15 shkurt 2024).

[46] "Avokati i Popullit i drejtohet Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 28 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës", Avokati i Popullit. (Shih linkun <https://oik-rks.org/2024/01/16/avokati-i-popullit-i-drejtohet-gjykates-kushtetuese-te-republikes-se-kosoves-me-kerkese-per-vleresimin-e-perputhshmerise-me-kushtetuten-te-nenit-28-te-ligjit-nr-08l-228-per-zgjedhjet-e-pergjithshme/>). (Qasur për herë të fundit me 15 shkurt 2024).

nr. 08/L-247, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-182 për konfliktet administrative, Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-227 për përfaqësimin e institucioneve shtetërore në procedura gjyqësore dhe Arbitrazh, votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-237 për kadastër të pronës së paluajtshme, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-218 për organizimin e tregut për produktet bujqësore, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-250 për ndryshime klimatike, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare si dhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-240 për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

IKD vlerëson se miratimi i ligjeve me rëndësi jetike përmes procedurave të shpejta mund të ketë pasoja të mëdha për procesin demokratik dhe sundimin e ligjit. Mungesa e debatit, pamundësia për t'i rishikuar në afate të konsiderueshme dokumentet nga ana e komisioneve, minon transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara në procesin legjislativ.

Kuvendi duhet të ofrojë mundësi që projektligjet përveç nënshtrimit të konsultimeve publike nga ana e Qeverisë në platformën online të konsultimeve publike, ato të shqyrtohen në publik dhe të ketë pjesëmarrje duke siguruar që qytetarët dhe grupet e interesit të jenë të informuar për ligjet e propozuara dhe të kenë mundësi të shprehin mendimet e tyre.

IKD i rekomandon Kuvendit që praktika e shmangieve procedurale mos të jetë kaq e shprehur. Në parim, procesi legjislativ duhet të jetë i rregullt, në mënyrë që të garantohet gjithëpërfshirje adekuate dhe transparencë dhe shmangiet duhet të praktikohen vetëm kur nga natyra e çështjes dhe urgjenca në trajtimin e saj e kërkojnë këtë. Aplikimi i këtij instituti pa iu përmbajtur këtyre kritereve paraqet humbje të kuptimit të këtij instituti dhe praktikë e dëmshme në procesin e ligjbërjes.

29. Mungesa e konsensusit për marrëveshjet ndërkombëtare dëmtoi interesin e qytetarëve

Sipas evidencës së ligjeve,[47] në legjislaturën VIII janë proceduar për miratim 279 projektligje prej të cilave 218 janë miratuar. Nga numri 279 i projektligjeve të proceduara, 67 janë marrëveshje ndërkombëtare, që i bie se një e katërta e projektligjeve të propozuara deri më tani janë marrëveshje ndërkombëtare, 55 deri më tani janë miratuar dhe janë në fuqi. Këto projektligje, duke qenë se brenda tyre kanë edhe marrëveshje ndërkombëtare kryesisht financiare, ato kërkojnë votën e shumicës absolute të deputetëve të Kuvendit (80 vota për). Andaj është e pamjaftueshme vota e deputetëve të shumicës parlamentare e kërkohet edhe vota e deputetëve të opozitës parlamentare.

Nga monitorimi që IKD i ka bërë procesit legjislativ, më shumë se gjysma e këtyre marrëveshjeve janë hedhur në votim në më shumë se tre herë dhe epilog final kanë marrë

[47] "Evidenca e ligjeve", 26 shkurt 2024. (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/uploads/Data/Documents/Evidencaeligjeve_vKt4uRsStH.pdf). Qasur për herë të fundit me 27 shkurt 2024.

vetëm pas përplasjeve pozitive me opozitën, por jo si rezultat i një dialogu të mirëfilltë dhe konsensusi të plotë për miratimin e tyre.

IKD ka gjetur se ka munguar iniciativa serioze dhe e mirëfilltë e Qeverisë ose grupit më të madh parlamentar që ka propozuar Qeverinë që të diskutojë në mënyrë transparente që këto marrëveshje të marrin epilog final pozitiv për faktin se marrëveshje të tilla janë në interes të qytetarit dhe ato në vete përmbajnë fonde që do të përmirësohet jeta e tyre sociale dhe ekonomike.

30. Pasojat e mungesës së pjesëmarrjes në punimet e Kuvendit të deputetëve nga komuniteti joshumicë serb

Më 7 nëntor 2022, dhjetë (10) deputetët e Grupit Parlamentar të Listës Serbe i dorëzuan dorëheqjet e tyre në Kuvendin e Kosovës.[48] Dorëheqjet u bënë për shkak të pakënaqësisë së tyre në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës për të zbatuar planin prej tri fazash për ri-regjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe.

Në pajtim me procedurën e përcaktuar me nenin 112, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, dorëheqjet e tyre u dorëzuan te Kryetari i Kuvendit, të cilat më pas të Presidentja e vendit e më pas ajo kërkoi nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), që brenda pesë ditëve të ofrojë kandidatët e radhës nga lista e njëjtë zgjedhore.

Përmbushja e këtij kriteri ligjor u bë duke i dërguar dhjetë deputetët e tjerë të cilët ishin në radhë për t'u betuar. Nëntë prej tyre ishin të Listës Serbe ndërsa një deputet vjen nga partia Iniciativa Qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë. Sipas Listës Serbe, vendimi për t'i dërguar deputetët ishte strategjik dhe politik, në mënyrë që këto mandate të mos mund t'i marrë ndonjë subjekt tjetër.

Nga monitorimi që IKD i bëri Kuvendit të Kosovës, ka gjetur se nëntë deputetët e LS-së dhe të IQLDM-së marrin pjesë vetëm në seancat plenare kur është kusht i domosdoshëm që të mos ju humbet mandati sipas Kushtetutës dhe Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.

Edhe pse me Kushtetutën e Kosovës, kësaj liste i takon të propozojë njërin nga nënkryetarët e Kryesisë, ata ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë. LS ende nuk ka propozuar edhe kryetarin e Komisionit për të Drejtat e Komuniteteve dhe për Kthim si njëri ndër komisionet parlamentare kushtetuese dhe komision i përhershëm, e për më tepër nuk ka propozuar as anëtarët e këtij komisioni. Lista Serbe nuk ka propozuar edhe anëtarët e tjerë për komisionet e tjera të përhershme dhe funksionale.

[48] Deputetët e dorëhequr janë: Slavko Simic, Igor Simic, Miljana Nikolic, Zoran Mojsilovic, Verica Ceranic, Branislav Nikolic, Milos Perovic, Ljubinko Karadzic, Jasmina Dedic dhe Dragana Antonijevic.

Sipas Rregullores së re të Kuvendit, grupi parlamentar formohet duke ia dorëzuar Kryetarit të Kuvendit një njoftim, të nënshkruar nga deputetët, të cilët e përbëjnë grupin parlamentar dhe ky njoftim duhet të përmbajë emrin e grupit, emrin e kryetarit të grupit dhe të nënkryetarit të grupit dhe për qëllimin e tyre të veprojnë si grup parlamentar dhe ky njoftim duhet të bëhet jo më vonë se shtatë (7) ditë nga dita e seancës konstituive, në këtë rast nga dita e betimit të tyre. Një gjë e tillë ende nuk është bërë nga grupi i deputetëve të betuar pas dorëheqjes së dhjetë deputetëve me 7 nëntor 2022. Rrjedhimisht, ata nuk i ushtrojnë disa të drejta, për të pasur zyrë, për të pasur staf dhe çështje të tjera të parapara me rregulloren e Kuvendit.

Si pasoja të tjera për shkak të mospjesëmarrjes së tyre në punimet e Kuvendit kemi mungesën e ushtrimit të përgjegjësisë së tyre si deputet në pajtim me Kushtetutën dhe me Ligjin, gjë që në këtë rast i obligon ata të jenë përgjegjës edhe para votuesve të tyre. Në anën tjetër, pasojat janë evidentuar edhe te pamundësia e Kryetarit të Kuvendit për t'i vendosur në votim ligjet me interes vital^[49] dhe pamundësinë për t'i hedhur në votim edhe amendamentet kushtetuese që lidhen me vettingun dhe amendamentin kushtetues në lidhje me Nenin 22 të Kushtetutës.

31. Bojkoti i deputetëve të Listës Serbe pamundëson votimin e propozim amendamenteve kushtetuese

Në përputhje me nenin 144, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës propozoi miratimin e amendamentit kushtetues nr. 27, i cili do të inkorporonte Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në nenin 22 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës konstatoi se propozim-amendamenti në asnjë mënyrë nuk i zvogëlon të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndërkohë, Komisioni për Legjislacion shqyrtoi këtë amendament dhe i rekomandoi Kuvendit që ta miratojë atë.

Përkundër faktit që në sallë ishin të pranishëm 86 deputetë të Kuvendit, Kryetari nuk e hodhi në votim këtë amendament për arsye se deputetët e Listës Serbe nuk ishin të pranishëm në sallë, rrjedhimisht nuk do të konsiderohej edhe i konsumuar ky proces.^[50]

Sipas Kushtetutës së Kosovës, çdo ndryshim i Kushtetutës kërkon miratimin e 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë këtu edhe 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara, ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës. Në këtë rast, nevojiten së paku edhe 14 vota të deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë.

[49] Shih për më shumë pamundësinë e hedhjes në votim në parim të Projektligjit nr. 08/L-210 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë në këtë link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/Proc_nr_102_dt_23_03_2023_SP_VrBk6uMfbm.pdf, fq. 10. (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

[50] "Transkript i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 5 tetor 2023. (Shih linkun https://www.assemblyofkosovo.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_10_05_ts_Seanca_ora10.00_v3qfjVcnn.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

IKD në këtë rast ka gjetur se Qeveria e Kosovës, Kryetari i Kuvendit dhe grupi më i madh parlamentar nuk kanë bërë përpjekjen minimale që të komunikojnë me deputetët e komunitetit joshumicë serb që të sigurojnë praninë e tyre në seancën e veçantë kur u hodhën këto propozime për t'u votuar.


32. Deklaratat jashtë rendit të ditës

Fjalimet e deputetëve të Kuvendit luajnë një rol kryesor në veprimtarinë parlamentare, veçanërisht kur këto fjalime nuk përkrijnë me pika të rendit të ditës që duhet t'u përmbahen për shkak të një projektligjin ose të ndonjë propozim vendimi. Në këtë drejtim, Kuvendi i ka kushtuar rëndësi të veçantë pikës së deklarimeve jashtë rendit të ditës e cila është e vendosur si pikë e dytë në çdo seancë të rregullt. Në këtë mënyrë, qytetarët mund të ngritin përmes deputetëve çështje që nuk mund të adresohen tek pikat e tjera dhe po në këtë pikë ata bëhen pjesë dhe dëgjojnë e shohin se për çka deklarohen përfaqësuesit e zgjedhur për çështjet që nuk janë në rend të ditës.

Angazhimet në këtë pikë të rendit të ditës i shërbejnë dhe kontribuojnë në procesin demokratik dhe në funksionimin e Qeverisë, sepse vetëm në këtë mënyrë deputetët mund t'i artikulojnë nevojat dhe qëndrimet e qytetarëve që përfaqësojnë kur këto kërkesa nuk adresohen nga qeveritarët.

Sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës, deputeti, në emër të grupit parlamentar ose në emër të tij, pasi të ketë njoftuar Kryetarin e Kuvendit, ai mund të diskutojë çështje të ndryshme që i konsideron se duhet të bëhen publike në mbledhje plenare. Deklarimi në emër të grupit parlamentar bëhet deri në pesë minuta ndërsa në emër të tij, ai nuk mund të flasë më shumë se tre (3) minuta. Koha maksimale për këtë pikë është 30 minuta (me rregulloren e vjetër, të shfuqizuar), ndërsa me rregulloren e re, 40 minuta.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka monitoruar këtë pikë të rëndësishme dhe në bazë të këtij monitorimi ka gjetur se 276 deklarata jashtë rendit të ditës u parashtruan nga deputetët e gjashtë grupeve parlamentare për 22 tema të caktuara.



Treguesi nr. 3 - Numri i deklaratave pozitë/opozitë

Temat që kanë përmendur deputetët te pika e deklarimeve jashtë rendit të ditës janë:


Numri i deklaratave	Tema/Çështja	Numri i deklaratave	Tema/Çështja
50	Dialogu Kosovë-Serbi	4	Infrastrukturë
46	Drejtësi	4	Histori
40	Siguri	3	Për procedurë
26	Efikasitet në Qeverisje	2	Liria e Medias
21	Ekonomi dhe Financa	2	Zgjedhja e organeve kolegjiale
16	Punë të Jashtme dhe Integrimi Evropian	1	Administratë Publike
15	Mirëqenia Sociale	1	Mjedis
12	Shëndetësi	1	Kulturë dhe Sport
12	Arsim	1	Lëvizja e lirë e njerëzve
10	Energji		
5	Çështje komunale		
4	Të drejtat e komuniteteve		

Tabela nr. 4 - Tema dhe numri i deklaratave jashtë rendit të ditës

Grupi me më së shumti deklarata jashtë rendit të ditës është ai i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i pasuar nga ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), më tutje nga ai i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (LV), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Grupit Parlamentar Multietnik dhe Grupit Parlamentar të Listës Serbe (LS) me asnjë një deklaram.



Treguesi nr. 4 Numri i deklaratave pozitë/opozitë.



Treguesi nr. 4 - Numri i deklaratave jashtë rendit të ditës në bazë të grupeve parlamentare

33. Heshtja e komuniteteve joshumicë

IKD gjen se nga të gjitha seancat e rregullta, Lista Serbe nuk është deklaruar as edhe njëherë te pika deklaratat jashtë rendit të ditës. Këtë të drejtë, LS ka mundur ta shfrytëzojë së paku 34 herë dhe të ngre çështje që lidhen me problemet e komunitetit serb, gjë të cilën nuk e ka bërë.

Fjalimet e mbajtura nga deputetët, veçanërisht në këtë pikë të rendit të ditës, luajnë një rol vendimtar në përfaqësimin e popullit të tyre, shprehjen e opinioneve, edukimin e publikut, ndikimin mbi legjislacionin dhe në promovimin e diskursit. Duke folur në emër të qytetarëve që i kanë votuar, deputetët sigurojnë që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh në procesin legjislativ dhe në vendimet e tjera që merr Kuvendi.

Si Kushtetuta e Kosovës, ashtu edhe legjislacioni tjetër, veçanërisht atij vital, deputetëve të komunitetit serb u është dhënë autoritet dhe kompetenca speciale që ata t'i përfaqësojnë dhe t'i mbrojnë interesat e tyre. IKD, në këtë drejtim gjen se deputetët përfaqësues të komunitetit serb nuk kanë arritur t'i adresojnë çështjet me interes jetik për ta. Rëndësia e pranisë së deputetëve nga radhët e komuniteteve joshumicë në Kuvend humbet nëse nuk trajtohen shqetësimet ekonomike, sociale, shëndetësore dhe të tjera. Është absurde të besohet se qytetarët serbë të Kosovës të mos kenë probleme që përfaqësuesit e tyre nuk i flasin në Kuvend.

Dhjetë deputetët e GP Lista Serbe, në nëntor të vitit 2022 me arsyetimin dhe kërkesën që Qeveria e Kosovës të tërheq vendimet e njëanshme dhe të kundërligjshme për reregjistrimin e veturave, ata i dorëzuan dorëheqjet e tyre në Kuvendin e Kosovës[51], derisa më 17 nëntor 2022 u betuan 10 deputetë të tjerë nga Lista Serbe.[52]

34. Llogaridhënia e Qeverisë përballë Kuvendit

Kuvendi ka në dispozicion një sërë mjetesh për ta mbajtur në llogaridhënie Qeverinë. Ky është njëri ndër tri funksionet kryesore të Kuvendit, funksioni mbikëqyrës i cili sipas Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së Kuvendit përmban instrumente të shumta për ta vendosë në llogaridhënie qeverinë.

IKD ka gjetur se Qeveria e Kosovës ka injoruar Kuvendin te pyetjet parlamentare për përgjigje me gojë, te komisionet hetimore dhe te debatet parlamentare për të dhënë përgjegjësi për punën e vet kushtetuese dhe për programin qeverisës të cilin e ka shpalosur para deputetëve në mars të vitit 2021.

[51] "Deputetët e Listës Serbe i dorëzojnë dorëheqjet e tyre zyrtarisht në Kuvendin e Kosovës". Betimi për Drejtësi, 7 nëntor 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejttesi.com/deputetet-e-listes-serbe-i-dorezojne-doreheqjet-e-tyre-zyrtarisht-ne-kuvendin-e-kosoves/>). Qasur për herë të fundit me 25 janar 2024).


[52] "Lista Serbe: I morëm mandatet në Kuvend për t'i ruajtur". Evropa e lirë, 17 nëntor 2022. (Shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/deputetet-serb-betohen-ne-kuvend/32134901.html>). Qasur për herë të fundit me 25 janar 2024).

IKD ka gjetur se përveç Qeverisë së Kosovës, edhe Kryetari ose ndonjëri nga nënkryetarët e Kuvendit nuk ka zbatuar në përpikëri Rregulloren e Kuvendit për t'i dhënë vërejtje publike kabinetit qeveritar kur shpërfill kërkesat e deputetëve.

34.1 Pyetjet parlamentare për përgjigje me gojë

IKD ka gjetur se deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë shfrytëzuar 262 herë^[53] të drejtën e parashtrimit të pyetjeve parlamentare ndaj kabinetit të qeverisë, që në raport me vitin 2022, i bie se ka pasur 28 pyetje më shumë. Këto pyetje, në vitin 2023 janë parashtruar të gjitha në pajtim me Rregulloren e re të Kuvendit.^[54] Sipas Rregullore së re, koha e ndarë për pyetjet parlamentare është 60 minuta për seancë dhe deputeti për një seancë plenare mund të parashtojë më së shumti dy pyetje.

Në total, 57% e pyetjeve u parashtruan nga dy grupet parlamentare që përbëjnë shumicën parlamentare, derisa 43% të pyetjeve u parashtruan nga grupet parlamentare opozitare. Grupi Parlamentar i Listës Serbe nuk parashtroi asnjë pyetje parlamentare.



Treguesi nr. 5 - Numri total i pyetjeve parlamentare dhe dallimi pozitë/opozitë

Numri i pyetjeve	Tema/Çështja	Numri i pyetjeve	Tema/Çështja
71	Infrastrukturë	6	Siguri
33	Arsim	6	Bujqësi
32	Kulturë dhe Sport	5	Drejtësi
31	Ekonomi dhe Financa	4	Energji
20	Shëndetësi	3	Çështje komunale
14	Punë të Jashtme dhe Integritet Evropian	1	Efikasitet në Qeverisje
9	Mirëqenie Sociale	1	Të drejtat e komuniteteve
9	Mjedis	1	Zgjedhja e organeve kolegjiale
7	Dialogu Kosovë-Serbi	1	Lëvizja e lirë e njerëzve
7	Administratë Publike	1	Diasporë


Tabela nr. 5 - Tema dhe numri i pyetjeve parlamentare.

[53] *Shënim i rëndësishëm*: Monitorimi i pyetjeve parlamentare është bërë duke u bazuar në transkriptet e publikuara në faqen e Kuvendit. Gjatë monitorimit është vërejtur që Kryetari i Kuvendit dhe në raste të caktuara edhe kryesuesit e seancave, nuk e precizojnë saktë dhe qartë, emrin dhe mbiemrin e deputetit si dhe kujt i është drejtuar pyetja parlamentare. Ky veprim për monitoruesit e IKD-së, ka paraqitur vështirësi në identifikimin dhe përcjelljen e pyetjes në rastet kur ka munguar Ministri/ja i/e caktuar në seancë plenare. Për këtë kapitull është kërkuar komentim i veçantë nga ana e Kuvendit të Kosovës për saktësinë në statistika të pyetjeve parlamentare.

[54] "Neni 92, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës", 2022, Kuvendi i Kosovës. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/2022_08_09_RregulloreKuvenditeRepublikeKosoves_LP5sAC4XSV.pdf). (Qasur për herë të fundit më 25 janar 2024).



Treguesi nr. 6 - Numri i pyetjeve parlamentare në bazë të grupeve parlamentare.



Treguesi nr. 7 - Përqindja e pyetjeve parlamentare në bazë të grupeve parlamentare

Nga 262 pyetjet parlamentare, 22 deputetë nuk ishin të pranishëm kur pyetjet parlamentare u lexuan nga Kryetari i Kuvendit. Shumica prej tyre munguan një herë, përdherisa pati deputetë që munduan dy herë dhe tre herë në parashtrimin e pyetjeve parlamentare.

Nga 262 pyetjet parlamentare, në 123 pyetje kanë munguar ministrat në seancën e parë të parashtrimit të këtyre pyetjeve, ndërsa në 139 pyetje parlamentare, kabineti qeveritar ka qenë i pranishëm në seancën e parë kur është parashtruar pyetja parlamentare.

Nga 262 pyetjet parlamentare, për shkak të mungesës së ministrave në Kuvend, 73 pyetje nuk kanë marrë përgjigjen e ministrave deri në seancën e fundit për vitin 2023. 22 prej këtyre pyetjeve i ishin adresuar vetëm për ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 10 pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, tetë pyetje për ministren e Punëve të Jashtme, tetë pyetje për ministrin e Financave, shtatë pyetje për Kryeministrin, gjashtë pyetje për ministrin e Kulturës, pesë pyetje për ministren e Arsimit.

Në mungesë të ministrave në seancë parlamentare, deputetët e Kuvendit kanë tërhequr nga 5 pyetje parlamentare, ngase kanë marrë përgjigje me shkrim ose presin përgjigje me shkrim. Nga 73 pyetjet parlamentare që nuk kanë marrë përgjigje, 45 prej tyre janë pyetje për të cilat ministrat kanë refuzuar të përgjigjen edhe pse kanë qenë të pranishëm në seancë plenare. Kryeministri dhe ministrat nuk janë përgjigjur me arsyetimin se deputetët e opozitës parlamentare nuk po marrin pjesë në votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Përgjithësisht, gjatë vitit 2023 IKD gjen se pyetjet parlamentare kanë qenë shpesh të paefektshme si një mjet për Kuvendin që ta mbajë qeverinë përgjegjëse. Shkaku kryesor i joefikasitetit në vitin 2023 ishte mospërfillja e Kuvendit nga ana e Qeverisë, veçanërisht tek kushtëzimi i Kryeministrit dhe ministrave në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Kryeministrit dhe ministrave duhet t'u bëhet e qartë se interesat e qytetarëve që dëshirojnë të dinë përgjigjet e pyetjeve specifike të përfaqësuesve të zgjedhur janë kryesore për të dhënë përgjigje para tyre dhe për çështjet që i shqetësojnë.

34.2 Mosdisiplinimi i Qeverisë

Kuvendi shënoi hapa pozitivë në vitin 2022 kur miratoi Rregulloren e re të Punës. Ndryshimet që u bënë atë vit i mundësuan Kryetarit të Kuvendit dhe kryesuesve të seancave plenare që t'i japin vërejtje kabinetit qeveritar në rastet kur nuk njofton për arsyet e mungesës kur ndonjë deputet parashtron pyetje parlamentare. Vërejtja bëhet publike në seancën plenare kur mungon Kryeministri ose ministri.

Zbatimi i kësaj dispozite, ashtu siç nuk u bë në asnjë rast në vitin 2022, situatë e njëjtë është edhe në vitin 2023.

Kryetari i Kuvendit nuk e zbatoi në asnjërin rast kur Kryeministri ose ministri/ja i/e caktuar ka munguar në seancë parlamentare. Sipas të dhënave të mbledhura, rezulton se në 123 pyetje parlamentare, ministra të caktuar të Qeverisë së Kosovës nuk ishin të pranishëm në seancën e parë plenare kur pyetja u parashtrua nga deputeti/ja i/e Kosovës. Në asnjë prej këtyre rasteve Kryetari i Kuvendit ose kryesuesi/ja e Kuvendit, asnjërit prej tyre nuk ua ka tërhequr vërejtjen Kryeministrit ose ministrave të caktuar për mungesën e tyre dhe për qasjen mospërfillëse ndaj Kuvendit dhe deputetëve. Në një seancë plenare, kryesuesja e seancës, nënkryetarja Saranda Bogujevci, njoftoi vetëm për një arsyetim që i është dërguar në rastin e mungesës e Kryeministrit të Kosovës.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se edhe në një rast tjetër, ministrat dërguan arsyetimin e tyre për pamundësinë e tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve parlamentare dhe atë vetëm në seancën e fundit e të veçantë kur në rend të ditës ishte pika e pyetjeve parlamentare.[55] Në anën tjetër, ministrat që dërguan arsyetimin e tyre bëjnë pjesë disa ministra që asnjëherë nuk kanë arsyetuar mungesën e tyre më parë ose ministra që nuk janë përgjigjur në asnjë pyetje plenare siç është rasti i ministrit të MPB-së, Xhelal Sveçla. Kur kësaj i shtohet fakti se në këtë seancë të veçantë munguan shtatë ministre/a, atëherë një seancë e tillë e veçantë nuk e mbërrin qëllimin për të cilin flet rregullorja e Kuvendit.

Vërejtjet që duhej të jepeshin nga Kryetari ose kryesuesi i seancës plenare:

- 22 vërejtje për ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe për Infrastrukturë;
- 10 vërejtje për ministrin e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike;
- 8 vërejtje për ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporë;
- 8 vërejtje për ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve;
- 8 vërejtje për Kryeministrin e Kosovës
- 7 vërejtje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

[55] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit", fq. 3, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 1 dhjetor 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_12_01_ts_Seanca_e9pfrqJn2B.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

- 5 vërejtje për ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- 5 vërejtje për ministrin e Shëndetësisë;
- 1 vërejtje për Zv. Kryeministren e tretë;
- 1 vërejtje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural;
- 2 vërejtje për ministren e Ekonomisë.

Në masë të mirë Kuvendi ka trajtuar te pyetjet parlamentare çështjen e ikjes së të rinjve nga Kosova për shkak të liberalizimit të vizave, por asnjë përgjigje nuk është marrë për këtë çështje nga ana e kabinetit qeveritar.[56]

IKD, te pyetjet parlamentare ka evidentuar edhe parashtrimin e një pyetjeje parlamentare në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, pyetje parlamentare e parashtruar nga deputetja Blerta Deliu-Kodra për Kryetarin e Kuvendit, qëndrimet e së cilës më shumë përkojnë me deklarin jashtë rendit të ditës. Edhe pse Kryetari është interpretuesi i fundit i Rregullores së Kuvendit, ai u lëshua në deklarime në lidhje me pyetjen e deputetes znj. Deliu, pyetje që edhe ai vetë thotë se pyetjet parashtrohen vetëm për Qeverinë.[57] Më tutje, në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, Kryetari lejon edhe deputetin nga ana e GP të LDK-së që të deklarohej për çështjen që e ngrit deputetja Deliu-Kodra.

IKD ka evidentuar raste kur pyetjet e deputetëve nuk marrin përgjigje nga një sesion në tjetrin, [58] ku nuk janë prezentë ministrat e caktuar. Po ashtu, IKD ka gjetur se përgjithësisht në secilën seancë plenare edhe deputetët mungojnë në parashtrimin e pyetjeje parlamentare. [59] Një praktikë e tillë shihet edhe në secilën seancë plenare të Kuvendit.[60] Kjo tregon nivelin e përgjegjësisë së deputetit për të ushtruar mandatin e tij në raport me kërkesat që vijnë nga qytetarët. Në këtë pikë të rendit të ditës, shumica prej çështjeve që ngrihen nga deputetët janë ankesa dhe kërkesa që vijnë nga qytetarët dhe ata presin që në atë seancë të dëgjojnë pyetjen dhe të dëgjojnë përgjigjen e ministrave.

Gjatë monitorimit të kësaj pike të rendit të ditës, IKD ka evidentuar një rast ku përkundër faktit që një pyetje parlamentare është dorëzuar dhe parashtruar në seancë plenare më shumë se katër herë, ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në seancë deklaroi se nuk është në dijeni të pyetjes parlamentare të parashtruar nga deputeti Mërgim Lushtaku.[61]

IKD ka evidentuar vetëm një rast ku Kryeministri është përgjigjur në pyetjen e deputetes Ariana Musliu-Shoshi për ministren e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla.[62]

[56] Shih për më shumë pyetjen e deputetit Elmi Reçica drejtuar Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti i cili nuk ishte i pranishëm në seancë: (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_12_01_ts_Seanca_e9pfrqJn2B.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

[57] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit", fq. 22 dhe 23. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 19 janar dhe 22 mars 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_01_19_ts_Seanca_a4jAshJMgt.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

[58] "Rasti i deputetes Ganimet Musliut në pyetjen ndaj Ministres së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, fq. 36 dhe 37, seanca plenare e dt. 02.02.2023". (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_02_02_ts_Seanca_ENMCLTep6.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

[59] Po aty. Mungesa e deputeteëve Mërgim Lushtaku, Floretë Zejnullahu, Blerta Deliu Kodra, Rrezarta Krasniqi.

[60] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit", fq. 28, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 09 mars 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_03_09_ts_Seanca_dPX6kntxad.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

[61] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit", fq. 23, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 6, 7 prill, 7 qershor dhe 27 korrik 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_03_09_ts_Seanca_dPX6kntxad.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

[62] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit", Kuvendi i Republikës së Kosovës, 16 shkurt 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_02_16_ts_Seanca_92ct3K4mTq.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

34.3 Kushtëzimi jokushtetues për të dhënë llogari përballë përfaqësuesve të qytetarëve

Me 6 tetor 2023, për herë të parë Kuvendi organizoi seancë të veçantë për parashtrimin e pyetjeve parlamentare ndaj kabinetit qeveritar. Kjo u mundësua falë dispozitave të reja të Rregullores të Kuvendit.[63]

Monitorimi i IKD-së në këtë pikë të rendit të ditës dhe në seancat e tjera pasuese ka gjetur se Kryeministri i Kosovës së bashku me ministrat e tjerë të qeverisë kanë kushtëzuar dhënien e përgjigjeve për deputetët me votimin e tyre për marrëveshjet ndërkombëtare.

Gjatë seancës me 9 tetor 2023, ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, nuk i përgjigjet deputetit Bekim Haxhiu me kushtëzimin për votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Ndërsa, kabineti qeveritar i përgjigjet vetëm deputetëve të shumicës parlamentare.

Gjatë këtyre seancave ku pikë e rendit të ditës janë pyetjet parlamentare e ku ministrat nuk i përgjigjen deputetëve opozitarë, IKD gjen mosangazhimin e kryesueses ose kryesuesit për të ndërmarrë veprime ndaj kabinetit qeveritar siç parashihet me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Në këso raste, Kryesuesi/ja do të duhej që të ndërpresë seancën, të konsultohet me Kryeministrin dhe kabinetin qeveritar që t'u kërkojë përgjigje në pyetjet e deputetëve. Në rast se përsëri nuk ndodh, atëherë kryesuesi do të duhej t'i tërheqë vërejtjet publike ndaj kabinetit qeveritar.[64] Refuzimi për t'iu përgjigjur pyetjeve parlamentare vazhdon edhe në seancat e tjera pasuese.[65]

IKD te seancat e veçanta për pyetjet parlamentare ka gjetur se ato në masë të madhe janë parashtruar nga shumica parlamentare e që nuk është e zakonshme kjo praktikë. Në seancën e veçantë me 6 tetor 2023, 35 pyetje u parashtruan nga shumica parlamentare dhe 10 nga opozita.

- 35 ose 78% pyetje nga shumica parlamentare
- 10 ose 22% nga opozita

IKD në dhjetëra raste ka gjetur se pyetjet parlamentare nuk kanë marrë përgjigje në më shumë se gjashtë herë të parashtrimin të tyre. Kjo ka ndodhur për arsye të mungesës së ministrave të caktuar të kabinetit qeveritar.

[63] Neni 92, paragrafi 9 i Rregullores së Kuvendit.

[64] "Kushtëzimi i Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti për përgjigjet në pyetjet parlamentare nëse deputetët e opozitës votojnë marrëveshjet ndërkombëtare", Kuvendi i Kosovës, 6 tetor 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_10_06_ts_Seanca_dYEqxtHsbL.pdf). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024.

[65] "Shih për më shumë refuzimin e Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci për t'iu përgjigjur deputetit Bekim Haxhiu", Kuvendi i Kosovës, 19 tetor 2023 (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_10_19_ts_Seanca,ora13.00_xAhr3xAV5V.pdf). (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

Humbja e aktualitetit të pyetjeve parlamentare i referohet situatave kur pyetjet e bëra nga deputetët (deputetët) ose ligjvënësit bëhen më pak të rëndësishme ose në kohë për shkak të ndryshimeve në rrethana ose ngjarje. Kjo mund të ndodhë për arsye të ndryshme.

IKD vlerëson se vonesat kohore për t'i trajtuar me kohë temat që parashtrohen përmes pyetjeve parlamentare e humbasin aktualitetin e tyre kur kalon kohë e gjatë që nuk adresohen nga kabineti qeveritar. Prej kohës kur parashtrohet një pyetje parlamentare mund të zhvillohen ngjarje ose situatat mund të ndryshojnë në atë mënyrë që çështja e ngritur bëhet e vjetruar ose më pak e rëndësishme.

Sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Qeverinë, Kryeministri dhe ministrat mbajnë përgjegjësi para Kuvendit. Prej tyre pritët që t'u përgjigjen pyetjeve të deputetëve, të jenë proaktiv në dhënien e informacioneve dhe të japin përgjegjësi për politikën dhe veprimet e tyre gjatë qeverisjes së tyre.[66] Edhe Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, ka përcaktuar taksativisht përgjegjësinë dhe obligimin e ministrave për t'u përgjigjur pyetjeve të deputetëve.[67]

Moslogaridhënia e Qeverisë ilustron shumë qartë kur në seancën e datës 19 tetor 2023, konstatohet nga Kryetari i Kuvendit për numrin e madh të pyetjeve parlamentare të bartura. Në këtë seancë të radhitura për t'u parashtruar ishin 53 pyetje në total, 36 të bartura dhe 17 të parashtruara për herë të parë.

- 6 të bartura
- 17 të parashtruara për herë të parë.

34.4 Interpelancat

Një grup parlamentar ose një grup deputetësh i përbërë nga të paktën gjashtë deputetë mund të përdorë instrumentin e interpelancës, si një mjet i kontrollit parlamentar, për të thirrur kryeministrin ose një ministër të caktuar për t'u përgjigjur pyetjeve dhe për të kërkuar informacion për një çështje thelbësore. Secili deputet i ka 1.5 minuta kohë për të paraqitur mendimin e tij gjatë një debati dhe në përputhje me rregulloren e Kuvendit, debati mund të zgjasë deri në tre orë.

Gjatë vitit 2023 u zhvillua vetëm një interpelancë e cila u parashtrua nga grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, përmes së cilës u ftua në interpelancë Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati për çështjen: "Rishikimi i Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe rritja e pagave në sektorin publik".

[66] "Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Neni 11, nënp. 1.12 dhe Neni 22 dhe Neni 25", Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 18 nëntor 2022. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66686>). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

[67] "Ligji Nr. 03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Neni 1, par. 1 dhe 2", Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 18 nëntor 2022. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66686>). Qasur për herë të fundit me 18 janar 2024).

Numrin kaq minimal të përdorimit të interpelancës, grupet parlamentare opozitare e kanë arsyetuar me faktin se një instrument i tillë grupeve të vogla parlamentare nuk u ofron kohë të duhur për t'i shprehur qëndrimet e tyre. Për këtë arsye, numri më i madh i mocioneve përmbajtjesore ka qenë i shprehur përmes propozimit të rezolutave dhe debateve parlamentare, ku për secilin deputet koha e rezervuar për të paraqitur qëndrimet i ka 10 minuta.

Një interpelancë tjetër e parashtruar nga kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, për ta ftuar Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në lidhje me çështjen: "Përgjegjësia e tij në raport me ambasadorin e Republikës së Kosovës në Kroaci, z. Martin Berishaj", u zvarrit me muaj të tërë dhe nuk u mbajt sipas afateve të parapara me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Në anën tjetër, IKD gjen se përkundër këmbënguljes së PDK-së për të mbajtur një interpelancë të tillë, ajo u tërhoq nga vetë propozuesi Abelard Tahiri në mbledhjen e Kryesisë së Kosovës të mbajtur më 2 tetor 2023.

Duke parë numrin aq të vogël të parashtrimit të interpelancave, kryesisht me arsyetimin se në të tilla seanca, koha e rezervuar për deputetët është mjaft e shkurtër, IKD i rekomandon Kuvendit ndryshimin e Rregullores së Kuvendit për zgjerimin e kësaj kohe në mënyrë që deputetët ta përdorin më shumë këtë mekanizëm të mbikëqyrjes parlamentare.

34.5 Debatet parlamentare

Kuvendi i Kosovës, aktivitetin e vet e zhvilloi edhe përmes parashtrimit të mocioneve përmbajtjesore duke propozuar rezoluta dhe rekomandime. Gjatë vitit 2023, Kuvendi zhvilloi debat për 12 mocione përmbajtjesore.

34.5.1 Kufizimi i paarsyeshëm i kohës nga Kryeministri i Kosovës për të qëndruar në sallë për t'iu përgjigjur çështjeve dhe pyetjeve të ngritura nga ana e deputetëve të Kuvendit

Me 2 mars 2023, GP i LDK-së parashtroi mocion për shqyrtimin e një çështjeje urgjente në lidhje me raportimin e Kryeministrit të Kosovës për dialogun Kosovë - Serbi. Sipas LDK-së, në takimin e mbajtur më 27 shkurt 2023 në takimin e ndërmjetësuar nga Bashkimit Evropian është arritur dakordimi për marrëveshje drejt normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas parashtruesit të mocionit, deputetit Lumir Abdixhiku, marrëveshja e publikuar përmbante 11 nene, por ka edhe një ankes të saj i cili nuk është bërë publik, andaj një gjë e tillë duhet të shqyrtohet në mënyrë urgjente në Kuvend.[68]

Fillimisht, IKD gjen se Kryetari i Kuvendit në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit lejon propozuesin që ta arsyetojë mocionin në kohëzgjatje më shumë se tre minuta aq sa është

[68] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2 mars 2023. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/DOBET-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2022.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

është përcaktuar me nenin 94, paragrafi 2. Së dyti, kufizimi i raportimit të Kryeministrit nga ora 13:00-16:00 për një çështje të rëndësishme siç është dialogu nuk përkon me premtimin e tij dhe të Qeverisë për llogaridhënie dhe transparencë të plotë në lidhje me dialogun.

34.5.2 Mosprania e Kryeministrit ose e Ministrit të Punëve të Brendshme në seancën e jashtëzakonshme për mbështetjen urgjente financiare për Policinë e Republikës së Kosovës

Më 19 tetor 2023, dyzet deputetë të Kuvendit të Kosovës, (PDK-LDK-AAK) parashtruan kërkesën për t'u mbajtur seancë e jashtëzakonshme në lidhje me miratimin e një rezolute për mbështetje urgjente financiare të Policisë së Kosovës.

IKD gjen se parashtruesit kishin paraqitur në mënyrë të rregullt mocionin përmbajtjesor dhe se për temën ishin njoftuar Kryeministri dhe kabineti qeveritar, por as Kryeministri e as ndonjëri nga ministrat, veçanërisht ai i Punëve të Brendshme nuk mori pjesë në këtë seancë ku u diskutua mbi gjendjen dhe kërkesat e Policisë së Kosovës të parashtruara nëpërmjet tri grupeve parlamentare opozitare.

Situatë e njëjtë u paraqit edhe me rastin e diskutimit mbi rezolutën e paraqitur nga tre grupet parlamentare opozitare më 26 tetor 2023 mbi rritjen e koeficientit të pagave. Në këtë mocion të propozuar nuk mori pjesë për të dhënë sqarime ose komente edhe Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.[69]

Në vendet me sistem demokratik kushtetues, ideja e llogaridhënies së qeverisë ndaj Kuvendit është thelbësore. Kuvendi në vazhdimësi dhe veçanërisht kur përmes seancës së jashtëzakonshme thërret në përgjegjësi bartësit e Qeverisë, atij duhet dhënë llogari për vendimet, veprimet dhe politikat e saj ose në anën tjetër për mos veprimet.

IKD vlerëson se një qasje e tillë është në kundërshtim me parimet themelore kushtetuese dhe me standardet ndërkombëtare për të cilat Kosova ka marrë përsipër t'i zbatojë.

Në vazhdimin e kësaj seance të mbajtur me 9 nëntor, Kuvendi nuk e miratoi mocionin e propozuar nga tri grupet parlamentare opozitare. Njëzetë e pesë (25) deputetë votuan për ndërsa 59 abstenuan, rrjedhimisht kjo rezolutë nuk u votua.

[68] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 26 tetor 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_10_26_ts_Seanca_YUTrFwMSzv.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[69] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 26 tetor 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_10_26_ts_Seanca_YUTrFwMSzv.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

Grupi/et inicues/e	Tema	Vendimi i Kuvendit për mocionin e propozuar
PDK	Zhvillimet në dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë	Mocioni nuk është miratuar.
LDK	Rritja e faturave të tatimit në pronë	Mocioni nuk është miratuar.
PDK	Situata e krijuar me rezervat shtetërore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Mocioni nuk është miratuar.
AAK	Puna dyvjeçare e Qeverisë së Kosovës	Mocioni nuk është miratuar.
PDK/LDK/AAK	Zhvillimet në Korporatën Energjetike të Kosovës dhe përgjegjësinë e institucioneve qendrore në sektorin energjetik	Kryetari i GP të PDK-së, e tërhoqi propozim-rezolutën.
Të gjitha GP-të	Raportimi i Kryeministrit mbi gjendjen e sigurisë në katër komunat në Veri të vendit	Nuk ka pasur rezolutë
Të gjitha GP-të	Rezolutë lidhur me dënimin e sulmit terrorist që u zhvillua nga grupet terroriste që hynë nga Serbia në Kosovë më 24 shtator 2023	Mocioni është miratuar.
PDK/LDK/AAK	Propozim-rezolutë për mbështetje urgjente financiare të Policisë së Republikës së Kosovës	Mocioni është miratuar.
PDK/LDK/AAK	Propozim-rezolutë për ngritjen e koeficientit të pagave	Nuk është propozuar mocion.
AAK	Deklarata për mbështetje të Rezolutës së PE e dt.19 tetor 2023, mbi zhvillimet e fundit në dialogun Serbi-Kosovë, dhe situatën në komunat veriore të Kosovës	Mocioni është miratuar.
PDK/LDK/AAK	Raportimi i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për takimin në Bruksel në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi	Mocioni nuk është miratuar.
PDK	Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023	Nuk është parashtruar rezolutë.

Tabela nr. 6 - Numri i debateve dhe i temave në bazë të grupeve parlamentare.

Kuvendi i ka miratuar dy mocionet gjatë këtij viti, njëri i propozuar nga Lëvizja VETËVENDOSJE! dhe një nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ky i fundit i harmonizuar me grupet e tjera parlamentare përderisa shtatë mocionet e tjera janë refuzuar. Në debate të tjera nuk është propozuar asnjë mocion përmbajtësor dhe në një debat parlamentar është tërhequr mocioni.

34.5.3 Mungesa e qasjes proaktive të Kryeministrit për të raportuar mbi zhvillimet në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Kuvendi i Kosovës dhe shoqëria në përgjithësi gjatë kësaj legjislature janë përballur me mungesën e informatave të duhura në lidhje me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti i cili ka fituar mandatin për të qeverisur me vendin, ka marrë përsipër që së bashku me zv. Kryeministrin e parë Besnik Bislimi të udhëheqin me dialogun.

IKD gjatë monitorimit të punës së Kuvendit ka gjetur se Kryeministri Kurti raportoi në Kuvend vetëm me kërkesë të grupeve parlamentare opozitare dhe asnjëherë me qasjen proaktive të tij për ta mbajtur të informuar Kuvendin për një temë me rëndësi siç është dialogu.

Grupet parlamentare opozitare (PDK, LDK dhe AAK) ftuan dy herë Kryeministrin Kurti për të raportuar mbi zhvillimet në dialog. Një herë në fillim të vitit 2023 dhe herën tjetër në fund të këtij viti.

34.5.4 Përfaqësuesit e qytetarëve nuk debatojnë për kërkesat e minatorëve të Trepçës dhe për paralajmërimet për grevë të Policisë

Më 25 tetor 2023, minatorët e Kombinatit Metalurgjik Trepça hynë në grevë me kërkesën për kushte më të mira, pagë më të mirë, për pagesa të rregullta mujore, për sigurime shëndetësore dhe jetësore. Përgjatë gjithë periudhës sa ata qëndruan në grevë, nuk u vizituan nga asnjë prej krerëve institucionalë, siç është Kryeministri, Kryeparlamentari dhe Presidentja e vendit. Për më tepër, në dy javët e para ata nuk u vizituan as nga ministrja e Ekonomisë, si ministri e linjës në strukturën organizative të së cilës është edhe Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike ku kujdeset për të gjitha çështjet që lidhen me ndërmarrjet publike. Sipas Ligjit për Trepçën, kompleksi metalurgjik Trepça është shoqëri aksionare: 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, ndërsa 20 për qind janë të punonjësve.

Me arsyetimin e neglizhencës së Qeverisë për ta trajtuar këtë temë, deputetët e partive opozitare në seancën e rregullt plenare më 2 nëntor propozuan që për situatën e krijuar në Trepçë të diskutohet në mënyrë urgjente. Një propozim të tillë e bëri kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri.[70]

Propozimi u përkrah nga grupet parlamentare opozitare, por u kundërshtua nga grupi më i madh parlamentar, ai i Lëvizjes VETËVENDOSJEI, me arsyetimin se më 31 tetor, në mbledhjen e rregullt të Komisionit për Ekonomi janë ftuar anëtarët e Sindikatës së Shoqërisë Aksionare "Trepça" për të diskutuar lidhur me kërkesat e tyre dhe se për këtë çështje është diskutuar me orë të tëra.

Përkundër faktit që 93 deputetë ishin të pranishëm, në votim morën pjesë 86 deputetë, ku prej tyre, 33 e përkrahën mocionin, 36 e kundërshtuan mocionin dhe 7 deputetë abstenuan. Rrjedhimisht, nuk kaloi mocioni i propozuar nga z. Abelard Tahiri.

Në të njëjtën seancë, kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, propozoi që si çështje urgjente të diskutohet edhe mbi paralajmërimin e policëve të Kosovës për të protestuar, respektivisht njësisë FIT, të cilët kanë kërkuar paga më të mira, pagesën e shtesës së rrezikshmërisë, çështjen e sigurimit shëndetësor, shtesat dhe me Ligjin për pensionim të parakohshëm.

Edhe në këtë rast, një pjesë e madhe e deputetëve vendosën që të mos diskutojnë për këtë temë. Të pranishëm ishin 94 deputetë, votuan vetëm 84, dhjetë deputetë nuk morën pjesë fare në votim, 34 e mbështetën mocionin, 50 abstenuan, kundër asnjë.

[70] "Transkript i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit", fq. 78. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2 nëntor 2023. (Shih linkun Transkript i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit", fq. 78. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2 nëntor 2023. (Shih linkun). (Qasur për herë të fundit me 28 janar 2024).

34.6 Komisionet Hetimore

Nga të dhënat e monitorimit gjatë vitit 2023, rezulton se Kuvendi themeloi dy komisione të reja hetimore, një komision hetimor parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje në Republikën e Kosovës si dhe një komision tjetër lidhur me procedurat për furnizimin dhe menaxhimin me rezervat shtetërore, si dhe keqpërdorimet dhe abuzimet e mundshme me rezervat shtetërore, nëpërmjet kualifikimit të procedurës si sekret shtetëror për furnizime të tilla. Ndërsa, punën e vazhduan edhe dy komisionet e tjera të themeluara gjatë vitit 2022, ai lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe KHP lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë në periudhën 2006-2022, në të gjitha nivelet në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në atë të ndërmarrjes publike.

33.6.1 Kundërkushtetutshmëria e Komisionit hetimor parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, GP i Lëvizjes VETËVENDOSJE! bëri të ditur se 40 deputetë kanë parashtruar kërkesë Kryesisë së Kuvendit për themelimin komisioni hetimor parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe të dhunës në familje në Republikën e Kosovës. Kuvendi këtë komision e themeloi më 23 mars 2023.

IKD vlerëson se themelimi i një komisioni të tillë është në kundërshtim me parimet e ndarjes së pushteteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me standarde ndërkombëtare. Sistemi i drejtësisë nuk mund t'i raportojë në asnjë rrethanë pushtetit legjislativ, qoftë edhe përmes një komisioni hetimor. Realizimi i këtij komisioni në praktikë i bie se punonjës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në këtë rast gjyqtarët dhe punonjësit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, në këtë rast prokurorët - do t'i raportojnë për punën e tyre deputetëve. Kjo përbën ndërhyrje të pastër në sistemin e drejtësisë.

Nga monitorimi që IKD i ka bërë seancës kur është themeluar komisioni, asnjë nga grupet parlamentare të tjera të pranishme në seancë nuk ka bërë kundërshtimin e themelimit të këtij komisioni mbi arsyet se një komision i tillë përbën ndërhyrje në punën e organeve të drejtësisë. Dhuna në familje, dhuna në bazë gjinore, dhuna seksuale janë prej çështjeve emergjente që duhet të merren institucionet në Kosovë. Por, praktika e trajtimit të këtyre rasteve përmes komisioneve parlamentare, nuk është adekuate, fillimisht duhet theksuar faktin se kjo çështje duhet të adresohet nga institucionet e drejtësisë, duhet që të funksionalizohet Ligji për mbikëqyrjen elektronike, që ende nuk është funksionalizuar. Një mbikëqyrje e tillë mund të realizohet përmes ngritjes së çështjeve me mekanizmin e interpelancës, pyetjeve parlamentare, kërkesës për raportim të ministrave të caktuar por jo kërkesës për të raportuar organet e sistemit të drejtësisë në komisione hetimor parlamentare.

34.6.2 Procedimi i kundërligjshëm për miratim i Raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Kryesia e Kuvendit të Kosovës në mënyrë të kundërligjshme vendosi që Draft-raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës të vendoset në rend dite në seancën plenare të datës 23 shkurt 2023.[71] Për më tepër, Kryetari i Kuvendit në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të mbajtur më 16 janar 2023, gjatë fjalës së tij përmendi faktin që raporti i KHP-së duhet të miratohet brenda mandatit të tij e pastaj të procedohet për shqyrtim në seancë plenare.[72] Por, përkundër dilemave të tij, ai mundësoi votimin e këtij raporti.

Dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-176 për hetim parlamentar kërkojnë miratimin e raportit përfundimtar nga ana e Komisionit me konsensus e në rast të mos arritjes së konsensusit, raporti të votohet me shumicë të thjeshtë të votave.[73] Për më tepër, sipas nenit 23 (5) të këtij ligji, shprehimisht thuhet se “Kryetari i Komisionit ia dorëzon raportin përfundimtar të Komisionit Kuvendit brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e aprovimit të tij nga Komisioni”, Një gjë e tillë nuk është bërë as në ditën e fundit të mandatit të këtij komisioni në mbledhjen e mbajtur me 15 dhjetor 2022 për shkak të mungesës së kuorumit. Sipas Kryetarit të Komisionit Hetimor, Driton Selmanajt, mungesa e kuorumit ka rezultuar si pasojë e bojkotit të deputetëve të grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!.

IKD në këtë rast gjen se Draft-raporti i Komisionit Hetimor u procedua për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare në kundërshtim me Ligjin për hetim parlamentar dhe në anën tjetër deputetët e grupit parlamentar duke mos marrë pjesë në mbledhjen e KHP-së vepruan në kundërshtim me detyrimin e tyre dhe përgjegjësitë kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutën e Kosovës. Sipas Ligjit për hetim parlamentar, deputetët anëtarë të KHP-së që nuk pajtohen me konkluzionet e raportit përfundimtar kanë të drejtën e paraqitjes së pikëpamjeve të tyre me një mendim të veçantë me shkrim i cili përmban arsyetimin dhe ky mendim i bashkëngjitet edhe raportit përfundimtar. Asnjë anëtar i KHP-së nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Më 3 maj 2023, përkundër që kishte proceduar në mënyrë të kundërligjshme, Kuvendi nuk e miratoi raportin përfundimtar të këtij komisioni.[74]

34.6.3 Shumica parlamentare pamundësoi kryerjen e mandatit të Komisionit Hetimor

Më 21 shtator 2023, me propozim të 41 deputetëve nga GP i PDK-së, GP i LDK-së dhe GP i AAK-së, Kuvendi themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar lidhur me çështjen e hetimit parlamentar

[71] "Transkript i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit", fq. 49. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 23 shkurt 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_02_23_ts_Seanca_qM3YphPKHF.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[72] "Procesverbal i Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit", Kuvendi i Republikës së Kosovës, 16 janar 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeDocumentFiles/Proc_nr_054_dt_16_01_2023_MK_znc6tUArmj.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[73] "Neni 23, par. 2, Ligji Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar", 2010, Kuvendi i Kosovës. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2683>). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[74] "Transkript i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 3 maj 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_02_23_ts_Seanca_qM3YphPKHF.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

lidhur me procedurat për furnizimin dhe menaxhimin me rezervat shtetërore dhe hetim parlamentar lidhur me mundësitë e keqpërdorimeve dhe abuzimeve me rezervat shtetërore nëpërmjet kualifikimit të procedurës si sekret shtetëror për furnizime të tilla.

Por, përkundër që KHP u themelua, ai nuk u konstitua deri në tentimin e tetë të tij, ngase në mbledhje nuk merrnin pjesë deputetët e shumicës parlamentare të cilët edhe kishin marrë pjesë në votimin e këtij komisioni.

IKD vlerëson se duke qenë që në procesin e votimit kanë marrë pjesë edhe deputetët që janë propozuar për anëtarë në këtë komision, është e pakuptimtë, joetike, jodemokratike dhe në mospërputhje me Kushtetutën, mandatin të cilin ua jep deputetëve, që ata të mos marrin pjesë në konstituimin e komisionit me ç'rast aty diskutohet edhe për planin e veprimit të KHP-së.

Për më tepër, deputetët kur nuk e konstituojnë KHP-në shkelin Ligjin për hetim parlamentar, sepse sipas këtij ligji, mbledhja e parë e komisionit mbahet jo më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë nga data e marrjes së vendimit të Kuvendit për themelimin e Komisionit.

KHP-të janë komisione ad hoc me mandat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj. Qëllimi i tyre është hetimi, informimi, rekomandimi dhe ushtrimi i mbikëqyrjes parlamentare drejt arritjes së një përfundimi rreth veprimeve procedurale dhe përgjegjësve qeveritarë ose shtetërorë të përfshirë në një çështje. Për t'u realizuar në praktikë këto veprime, deputetët duhet të marrin pjesë në komision, përndryshe mandati i KHP-së sipas vendimit të Kuvendit do të pushojë në mënyrë të heshtur.

Gjatë vitit 2023, Kuvendi miratoi Raportin lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë në periudhën 2006-2022, në të gjitha nivelet në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në atë të ndërmarrjes publike.

Annex 1: Aktiviteti total i deputetëve


Nga monitorimi i të gjitha fjalimeve të deputetëve të Kuvendit, rezulton se gjatë vitit 2023, deputetët e Kuvendit kanë mbajtur gjithsej 2114 fjalime.

Në vijim janë paraqitur çështjet të cilat kanë qenë objekt i trajtimit nga deputetët.

Tema/Çështja	Numri i deklaratave	%	Tema/Çështja	Numri i deklaratave	%
Ekonomi dhe Financa	496	24%	Efikasitet në Qeverisje	65	3%
Drejtësi	234	11%	Kulturë dhe Sport	44	2%
Dialogu Kosovë-Serbi	234	11%	Mjedisi	31	2%
Mirëqenie Sociale	218	10%	Bujqësi	8	0,4%
Siguri	167	8%	Çështje komunale	8	0,4%
Energji	126	6%	Të drejtat e komuniteteve	7	0,3%
Arsim	87	4%	Histori	6	0,3%
Punë të Jashtmedhe Integrimi Evropiane	85	4%	Diasporë	3	0,1%
Shëndetësi	81	4%	Liria e medias	2	0,1%
Administratë Publike	79	4%	Zgjedhja e organeve kolegjiale	1	0%
Për procedurë	67	3%			
Infrastrukturë	65	3%			

Tabela nr. 7 - Numri i deklaratave të deputetëve në bazë të 22 temave të ngritura gjatë aktivitetit në seancat plenare të Kuvendit

Grupi me më së shumti deklarata në të gjithë aktivitetin parlamentar është ai i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, i pasuar nga ai i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), më tutje nga ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Grupit Parlamentar MULTIETNIK dhe deputetët pa grup parlamentar. Lista Serbe nuk ka pasur asnjë deklaratë në të gjithë aktivitetin në seancë plenare.



Treguesi nr. 8 - Numri total i deklaratave në bazë të grupeve parlamentare.

Në bazë të deklaratave të deputetëve, rezultojnë se 15 deputetë nuk kanë ngritur asnjë çështje nga totali i 2114 deklaratave gjatë vitit 2023, ku prej këtyre deputetëve 9 janë grupit parlamentar të Listës Serbe, një nga GP LV, një nga GP LDK, një nga GP MULTIETNIK, një deputet i subjektit politik GI za Slobodu, Pravdu i Opstanak (GI SPO), një deputet nga Partia Unike Gorane (JGP) dhe Një deputet nga subjekti politik Romani Iniciativa (RI).

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
1	Besnik Tahiri	AAK	89	16	Mirlinda Tishukaj Sadiku	LV	41
2	Armend Muja	LV	77	17	Rashit Qalaj	PDK	40
3	Abelard Tahiri	PDK	71	18	Ariana Musliu - Shoshi	PDK	39
4	Arben Gashi	LDK	61	19	Hajdar Beqa	PDK	38
5	Ferat Shala	PDK	60	20	Pal Lekaj	AAK	37
6	Bekim Haxhiu	PDK	58	21	Mërgim Lushtaku	PDK	35
7	Adnan Rrustemi	LV	57	22	Avdullah Hoti	LDK	34
8	Ganimete Musliu	PDK	57	23	Valentina Bunjaku Rexhepi	LDK	32
9	Hykmete Bajrami	LDK	56	24	Ardian Gola	LV	31
10	Armend Zemaj	LDK	56	25	Dimal Basha	LV	30
11	Mimoza Kusari Lila	LV	53	26	Haki Abazi	PG	30
12	Driton Selmanaj	LDK	48	27	Elmi Reçica	PDK	28
13	Time Kadrijaj	AAK	47	28	Memli Krasniqi	PDK	28
14	Blerta Deliu Kodra	PDK	46	29	Jahja Kokaj	LV	27
15	Eliza Hoxha	PDK	44	30	Shemsedin Dreshaj	AAK	27

Tabela nr. 7 dhe 8 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për vitin 2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
31	Doarsa Kica Xhelili	LDK	26	46	Enver Dugolli	LV	15
32	Hisen Berisha	PDK	26	47	Nijazi Isaku	LV	15
33	Jeta Statovci	LV	26	48	Halil Thaçi	LV	14
34	Lumir Abdixhiku	LDK	24	49	Ramush Haradinaj	AAK	14
35	Albana Bytyqi	AAK	22	50	Rrezarta Krasniqi	LDK	14
36	Arjeta Fejza	LV	22	51	Floretë Zejnullahu	PDK	14
37	Albena Reshitaj	AAK	21	52	Agon Batusha	LV	13
38	Fatmire Kollçaku Mulhaxha	LV	21	53	Marigona Geci	LDK	13
39	Valon Ramadani	LV	20	54	Besim Muzaqi	LV	12
40	Driton Hyseni	LV	19	55	Ardian Kastrati	PDK	11
41	Besian Mustafa	LDK	18	56	Enis Kërvan	MULTIETNIK	11
42	Fitore Pacolli - Dalipi	LV	18	57	Enver Hoxhaj	PDK	11
43	Isak Shabani	PDK	18	58	Jetmire Vrenezi	LV	11
44	Bekë Berisha	AAK	17	59	Milazim Salijaj	LV	11
45	Eman Rrahmani	LV	16	60	Luan Aliu	LV	11

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
61	Anton Quni	LDK	10	76	Agim Veliu	LDK	6
62	Arijeta Rexhepi	LV	10	77	Avni Dehari	LV	6
63	Burim Meta	LV	10	78	Fjolla Ujkani	LV	6
64	Duda Balje	MULTIETNIK	10	79	Arbëreshë Kryeziu Hyseni	LV	5
65	Haxhi Avdyli	LV	10	80	Gramos Agusholli	LV	5
66	Kujtim Shala	LDK	10	81	Tinka Kurti	LV	5
67	Arta Bajralia	LV	10	82	Adelina Grainca	LV	4
68	Alban Bajrami	LV	9	83	Fatmir Humolli	PG	4
69	Artan Abrashi	LV	9	84	Fridon Lala	MULTIETNIK	4
70	Visar Korenica	LV	9	85	Gazmend Gjyshinca	LV	5
71	Vlora Dumoshi	LDK	8	86	Mefail Bajqinovci	LV	4
72	Enver Haliti	LV	7	87	Mirsad Shkreta	LV	4
73	Shqipe Isufi	LV	7	88	Saranda Bogujevci	LV	4
74	Yllëza Hoti	LV	7	89	Shqipe Mehmeti Selimi	LV	4
75	Arbër Rexhaj	LV	7	90	Vendenis Lahu	LV	4

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
91	Xhavit Haliti	PDK	4	106	Adem Hodza	JPG	0
92	Erxhan Galushi	MULTIETNIK	4	107	Behgjet Pacolli	LDK	0
93	Fidan Jilta	MULTIETNIK	4	108	Bekim Arifi	MULTIETNIK	0
94	Glauk Konjufca	LV	4	109	Biljana Maksic	LS	0
95	Hydajet Hyseni - Kaloshi	LV	4	110	Cvetko Veljkovic	GISPO	0
96	Nasuf Bejta	LV	3	111	Fadil Gashi	RI	0
97	Adriana Matoshi	LV	3	112	Fitim Uka	LV	0
98	Gani Krasniqi	LV	3	113	Ksenija Bozovic	LS	0
99	Labinotë Demi - Murtezi	LV	3	114	Milan Joksimovic	LS	0
100	Samra Iljaz	MULTIETNIK	3	115	Milan Kostic	LS	0
101	Salih Zyba	LV	2	116	Nenad Radenkovic	LS	0
102	Bahrim Sabani	MULTIETNIK	2	117	Olivera Zdravkovic	LS	0
103	Drita Millaku	LV	2	118	Rados Mihajlovic	LS	0
104	Fitim Haziri	LV	2	119	Svetislav Jokic	LS	0
105	Ekrem Mustafa	LV	2	120	Zoran Maksimovic	LS	0

Tabela nr. 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14- Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për vitin 2023

21. Annex 2: Kuvendi në numra

Më 22 mars 2021, u konstitua Kuvendi i Kosovës pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në shkurt të po këtij viti. Në po të njëjtën seancë, Kuvendi zgjodhi për Kryetar të Kuvendit, Glauk Konjufcën, nga partia më e madhe parlamentare si dhe u zgjodh Qeveria e Kosovës, në krye të së cilës ishte votuar Kryeministri Albin Kurti.

Përgjatë kësaj legjislature ende në vazhdim, ishte një deputete nga ana e GP të PDK-së, e cila kaloi në GP të LVV-së, dhe një deputete nga LVV që kaloi në GP të LDK-së. Ndërsa, dy deputetë të GP të LVV-së, dhanë dorëheqje nga ky grup por duke qëndruar në kuvend si deputetë të pavarur.


Bazuar në rezultatin dhe zgjedhor dhe ndryshimet e bëra, në fund të vitit 2023, përbërja e grupeve parlamentare të konfirmuara ishte si në vijim:

Nr.	Grupi parlamentar	Numri i deputetëve më 22 mars 2021	Numri i deputetëve më 31 dhjetor 2023
1	Lëvizja VETËVENDOSJE!	58	56
2	Partia Demokratike e Kosovës	19	18
3	Lidhja Demokratike e Kosovës	15	16
3	Lista Serbe	10	9
4	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	8	8
5	Multietnik	8	8
6	Pa grup parlamentar	2	5

Tabela nr. 15 - Përbërja e grupeve parlamentare të konfirmuara deri në fund të vitit 2023

Struktura e deputetëve në bazë të gjinisë: 40 gra - 80 burra.

Udhëheqja e komisioneve parlamentare, në bazë të grupeve parlamentare



Në bazë të strukturës gjinore:

- 7 komisione të udhëhequra nga gratë deputete
- 6 komisione të udhëhequra nga burrat deputetë

Publikimi i Doracakut për Nisma Legjislative



”

E përgëzoj Institutin e Kosovës për Drejtësi dhe stafin e tyre për punën e tyre që kanë bërë për publikimin e Doracakut.

Nëse e shohim se çka ka ndodh deri tash, prej vitit 2011 për 12 vite më radhë prej kur kjo ekziston ky ligj, atëherë e kuptojmë se sa të madhe e ka rëndësinë ky doracak, për arsye se vetëm 4 herë ka ndodhur kjo kur qytetarët të ndërmarrin një nismë legjislative

Glauk Konjufca, Kryetar i Kuvendit të Kosovës

Në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë, më 15 shtator 2023, Instituti i Kosovës për Drejtësi në bashkëpunim me Forumin për Transparencë Parlamentare në hapësirat e Kuvendit publikuan Doracakun për Nisma Legjislative nga qytetarët.

IKD, këtë iniciativë e ndërmori për arsye se në publik kishte mungesë të shpjegimit dhe informimit publik për procedurën, qasjen dhe metodën që duhet ndjekur për të garantuar pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në politikëbërje. Hapat e shpjeguar në doracakun e publikuar dhe shkresat e përdorura kanë bërë që dy nisma të qytetarëve të rezultojnë të suksesshme sa i përket procedurës së ndjekur.

Domosdoshmërinë e hartimit të një doracaku të tillë, si një udhërrëfyes që shpjegon detajisht procedurat dhe hapat që duhet të ndiqen për të iniciuar një nismë legjislative, në këtë tryezë e përshëndeti Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca.

Hartimin e Doracakut e përshëndetën edhe Nancy Soderberg, drejtoreshë e lartë e National Democratic Institute në Kosovë, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, deputete dhe kryetare e Forumit për Transparencë Parlamentare, deputetja Blerta Deliu-Kodra, deputeti Driton Selmanaj dhe deputeti Fridon Lala.

Doracaku në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze mund të shkarkohet në këtë link:

<https://kli-ks.org/doracak-nismat-legjislative-per-qytetare/>

Kontakt

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD
Adresa: Rruga “Ilaz Agushi”, Numër 146.
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

E-mail: info@kli-ks.org
Ueb: www.kli-ks.org